



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale / Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite

Ministry of Labour and Social Welfare

DEPARTAMENTI I PUNËS DHE PUNËSIMIT

PUNA DHE PUNËSIMI



Raporti Vjetor 2014

Editor : Shpetim KALLUDRA, Shef i Sektorit
Sektori për Analiza ne Tregun e Punës dhe TI-se, DPP/MPMS
shpëtim.kalludra@rks-gov.net

Hafiz LEKA, Kryesues
Divizioni i Punësimit, DPP/MPMS
Hafiz.leka@rks-gov.net

Jehona Namani-REXHA, Kryesuese
Divizioni i Aftësimit Profesional, DPP/MPMS
jehonanamani@hotmail.com

Ylber ALIU, Kryesues
Divizioni për Koordinimin e Zyrave te Punësimit, DPP/MPMS
ylber.aliu@rks-gov.net

Përgjegjës Defrim RIFAJ, Drejtor
Departamenti i Punës dhe Punësimit
Dëfrim.rifaj@rks-gov.net

Falënderojmë
Qendrat Rajonale te Punësimit dhe Zyrat Komunale te Punësimit
Qendrat e Aftësimit Profesional

Adresa Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Rr. UÇK-se Nr.1
10000 Prishtinë, Kosovë

Botuesi Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Data e botimit: Mars 2015
©: Departamenti i Punës dhe Punësimit /MPMS

Përmbajtja		Faqe
HARTA E KOSOVËS		4
SHKURTIMET		5
LISTA E TABELAVE		6
LISTA E FIGURAVE		7
Hyrje		8
Objektivat dhe Metodologjia		8
Përmbledhje ekzekutive		9
1	Punëkërkesit e Regjistruar	11
1.1.	Punëkërkesit e regjistruar	12
1.2.	Regjistrimi i punëkërkesve sipas kualifikimeve	12
1.3.	Regjistrimi i punëkërkesve sipas moshës	13
1.4.	Regjistrimi i punëkërkesve sipas etnitetit	13
1.5.	Regjistrimi i punëkërkesve sipas gjinisë	14
1.6.	Zhvillimet Rajonale	16
2	Papunësia e Regjistruar	18
2.1	Regjistrimi i papunësisë sipas kualifikimeve	18
2.2	Regjistrimi i papunësisë sipas moshe	19
2.3	Regjistrimi i papunësisë sipas etnitetit	19
2.4.	Regjistrimi i papunësisë sipas rajoneve	20
3	Vendet e lira të Punës	21
3.1	Vendet e lira	22
3.2	Vendet e lira sipas Sektorit	22
3.3	Vendet e lira sipas Kualifikimit	23
3.4	Vendet e lira sipas Rajonit	24
4	Punësimet e ndërmjetësuar	26
4.1	Punësimet sipas Sektorit	27
4.2	Punësimet sipas Kualifikimeve	28
4.3	Punësimet sipas Moshës	29
4.4	Punësimet sipas Etnitetit	29
4.5	Punësimet sipas Gjinisë	30
4.6	Punësimet sipas Rajonit	31
5	Aftësimet Profesionale	32
5.1	Aftësimet sipas kualifikimeve	33
5.2	Aftësimet sipas Moshës	33
5.3	Aftësimet sipas Etnitetit	34
5.4	Aftësimet sipas Gjinisë	35
5.5	Aftësimet sipas Rajonit	36
Aneks A	Projektet e realizuara gjatë vitit 2014	37
Aneks B	Treguesit e Popullsisë dhe treguesit e Tregut të Punës	41
Aneks C	Regjistrimi i personave me aftësi të kufizuara	42
Aneks D	Kërkesa gjatë vitit 2014	44
Definicionet dhe Terminologjia		46

HARTA E KOSOVËS

Departamenti i Punës dhe Punësimi

- Zyrat e Punësimi
- Qendrat e Aftësimi Profesional në Kosovë



SHKURTESAT

DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimi
DMS	Departamenti i Mirëqenies Sociale
DP	Divizioni i Punësimi
ONP/ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës/Zyra Ndërkombëtare e Punës (ILO)
ONM	Organizata Ndërkombëtare e Migrimit (IOM)
FMN/IMF	Fondi Monetar Ndërkombëtar
MBPZhR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
ZKP	Zyra Komunale e Punësimi
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
QRP	Qendra Rajonale e Punësimi
ZSK	Zyra e Statistikave të Kosovës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
QAP	Qendra për Aftësim Profesional
DAP	Divizioni për Aftësim Profesional
BB	Banka Botërore
MPCSHB	Ministria e Punës, Çështjeve dhe Shanseve të Barabarta
AESh	Anketa e Ekonomive Shtëpiake
HZhNJ	Hulumtimi i Zhvillimit Njerëzor
SNKA/ISCED	Standardi Ndërkombëtar për Klasifikimin e Arsimit
SNKP	Standardi Ndërkombëtar për Klasifikimin e Profesioneve
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
SNKAE	Standardi Ndërkombëtar për Klasifikimin dhe Aktiviteteve Ekonomike

LISTA E TABELAVE

	Përmbajtja	Faqe
Tabela 1	Punëkërkuesit e regjistruar	11
Tabela 2	Punëkërkuesit sipas Kualifikimeve	12
Tabela 3	Punëkërkuesit sipas Moshës	13
Tabela 4	Punëkërkuesit sipas Etnitetit	13
Tabela 5	Punëkërkuesit sipas Gjinisë	14
Tabela 6	Hyrjet e Papunësisë sipas Rajonit	16
Tabela 7	Punëkërkuesit sipas Proporcionit të Stafit	16
Tabela 8	Papunësia e regjistruar	18
Tabela 9	Papunësia sipas Kualifikimeve	18
Tabela 10	Papunësia sipas Moshës	19
Tabela 11	Papunësia sipas Etnitetit	19
Tabela 12	Papunësia sipas rajoneve	20
Tabela 13	Vendet e Lira sipas Kualifikimeve	23
Tabela 14	Vendet e Lira sipas Rajoneve	24
Tabela 15	Punësimet, Vendet e lira, Shkallët	26
Tabela 16	Punësimet sipas kualifikimeve / Punësimet-Shkallët	28
Tabela 17	Punësimet sipas Moshës	29
Tabela 18	Punësimet sipas Etniteteve	29
Tabela 19	Punësimet sipas Gjinisë	30
Tabela 20	Punësimet sipas Rajoneve	31
Tabela 21	Trajnimet Profesionale sipas Kualifikimeve	33
Tabela 22	Trajnimet Profesionale sipas Moshës	33
Tabela 23	Trajnimet Profesionale sipas Etnitetit	34
Tabela 24	Trajnimet Profesionale sipas Gjinisë	35
Tabela 25	Trajnimet Profesionale sipas Rajoneve	36
Tabela 26	Pasqyra Rajonale e Papunësisë	42
Tabela 27	Punësimet sipas Sektorit / SNKAE	44
Tabela 28	Vendet e Lira sipas Sektorit / SNKAE	44
Tabela 29	Të regjistruarit me Aftësi të Kufizuara	44
Tabela 30	Të regjistruarit me Aftësi të Kufizuara	

LISTA E FIGURAVE

	Përmbajtja	Faqe
Figura 1	Shkalla e Rritjes së Regjistrimeve	18
Figura 2	Rritja e regjistrimeve sipas Kualifikimeve	19
Figura 3	Shkalla e Rritjes / Mosha	20
Figura 4	Shkalla e Rritjes sipas Etnitetit	21
Figura 5	Dalja Proporcionale sipas Gjinisë	22
Figura 6	Shkalla e Rritjes sipas Rajonit	25
Figura 7	Dalja në Raport me Stafin 2012	26
Figura 8	Dalja në Raport me Stafin 2011	26
Figura 9	Shërbimet e Punësimi	27
Figura 10	Vendet e Lira	28
Figura 11	Vendet e Lira sipas Sektorëve Ekonomik	28
Figura 12	Vendet e Lira sipas Pronarit	29
Figura 13	ShVL sipas Kualifikimeve	30
Figura 14	ShVL sipas Rajonit	31
Figura 15	ShVLS sipas Rajonit	31
Figura 16	Punësimet	32
Figura 17	Punësimet sipas Sektorit	33
Figura 18	Punësimet sipas Pronarit	33
Figura 19	Punësimet Rate sipas Kualifikimeve	34
Figura 20	SHPVL sipas Kualifikimeve	35
Figura 21	Shkalla e Punësimi sipas Moshës	36
Figura 22	Shkalla e Punësimi sipas Etnitetit	37
Figura 23	Shkalla e Punësimi sipas Rajonit	38
Figura 24	Shkalla e Punësimi sipas Stafit	39
Figura 25	Pjesëmarrësit e Aftësimeve Profesionale	40
Figura 26	Shkalla e Aktivizimit sipas Kualifikimeve	41
Figura 27	Shkalla e Aktivizimit sipas Moshës	42
Figura 28	Shkalla e Aktivizimit sipas Etnitetit	42
Figura 29	Shkalla e Aktivizimit sipas Gjinisë	43
Figura 30	Shkalla e Aktivizimit sipas Rajoneve	44
Figura 31	Hyrja sipas Gjinisë	53
Figura 32	Daljet sipas Gjinisë	53
Figura 33	Punësimet sipas Gjinisë	53
Figura 34	Punësimet sipas Sektorit	54
Figura 35	Punësimet sipas Pronarit	54
Figura 36	Grupet me Përparësi për Punësim Të Rinjtë dhe të Pakualifikuarit	54

Hyrje

Raporti Vjetor “Puna dhe Punësimi” si raport i punës se DPP-se në vazhdimësi që prej vitit 2003, adreson çështje që ndërlidhen me punësimin dhe aftësimin në Kosovë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar performancës së aktiviteteve që janë ndërmarrë nga Departamenti i Punës dhe Punësimit (DPP) të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) – përkatësisht Divizioni i saj për Politika të Punësimit, Divizionit të Monitorimit dhe Koordinimit të Zyrave të Punësimit dhe Divizioni për Aftësim Profesional.

Zyrat e Punësimit kane mbajtur evidenca për punëkërkuessit e regjistruar dhe të papunësuarit e regjistruar. Nga këto dy kategori, papunësuarit e regjistruar kanë qenë të obliguar të paraqiten rregullisht çdo tre (3) muaj dhe në çdo thirrje të Zyrave të Punësimit.

Mirëpo, për shkak të reformave të ndërmarrura për ShPP-te e tilla si zhvillimi i shërbimeve shume kanalesh e cila do të lejojë punëkërkuessit dhe punëdhënësit qasje në shërbime të punësimit online nga kompjuterët e tyre ose nga telefonat e mençur, si dhe avancimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Punësimit (SIMP) prej vitit të ardhshëm, përkufizimi i kategorisë për “punëkërkuessve të regjistruar” do të ndryshojë dhe do të përfshijë të gjithë ata që janë të regjistruar nga jashtë (përmes interneti) të cilët nuk obligohen të vijnë në zyrat e punësimit. Mirëpo kjo kategori mund të marrë shërbimet e nevojshëm pa ardhur fare në zyrat e punësimit përmes kompjuterët e tyre si dhe nga telefonat e mençur. Kështu që nga viti 2015 do të raportohet vetëm për të papunët të regjistruar të cilët vijnë fizikisht për tu regjistruar në zyrat e punësimit dhe që paraqiten çdo 3 muaj. Nëse nuk paraqiten në Zyrat të Punësimit dy (2) herë radhas (3+3 muaj) atëherë këta persona janë jo aktiv dhe i ndërprerët mbajtja e evidencës.

Objektivat dhe Metodologjia- Raporti i Performances pasqyron pjesën më të madhe të shërbimeve që ofrohen nga zyrat e punësimit dhe qendrat e aftësimit profesional. Paraqet të gjitha zhvillimet si, regjistrimin e punëkërkuessve, të papunëve ndërmjetësimin në punësim dhe aftësimin profesional. Fokusi kryesor është i drejtuar në zhvillimin e shifrave të brendshme dhe indikatorët e brendshëm të performancës, duke krahasuar shifrat dhe zhvillimet e vitit 2014 me rezultatet e vitit 2013, dhe në disa raste edhe për vitet paraprake. Prandaj shifrat e përdorura në këtë raport kryesisht u referohen të dhënave të mbledhura nga sistemi Informativ për Menaxhimin e Punësimit (SIMP), nga zyrtarët e Zyrave të Punësimit (ZP) dhe nga Qendrat për Aftësim Profesional (QAP). Në bazë të kësaj, DPP-ja ka zhvilluar Sistemin Informativ për Menaxhimin e Punësimit, ku nga ky aplikacion nxjerrën të gjitha të dhënat si; papunësinë e regjistruar, vendet e lira të punës, ndërmjetësimet në punësim dhe hyrjet në aftësimet profesionale. Po ashtu këto të dhëna janë të ndara sipas gjinisë, kualifikimit, grup moshës, etnitetit, rajonit, sektorit të aktivitetit, sektorit sipas pronësisë etj. Sa u përket përcaktuesve të jashtëm të tregut të punës, siç është popullata, popullata me moshë punuese, popullata aktive dhe punësimi, raporti i referohet institucioneve tjera si burime sekondare.

Objektivat kryesorë të këtij raporti janë për mbështetjen e procesit të vendim marrjes dhe dizajnit të politikave brenda MPMS-së. Për më tepër ka për qëllim që të japë informata transparente në lidhje me zhvillimin e punës dhe punësimit për të gjitha institucionet relevante dhe për publikun e gjerë sipas interesimit, duke:

- Paraqitur dhe analizuar strukturat dhe faktet e papunësisë së regjistruar, aspekteve socio-demografike, gjinisë, kualifikimeve, moshës dhe etnitetit;
- Analizimi i vendeve të lira të punës të ofruara dhe punësimet e realizuara, përmes shërbimeve publike të punësimit. Në baze të aspekteve socio-demografike si dhe aspekteve strukturale të anës kërkuese, siç janë sektorët sipas aktivitetit dhe pronësisë;
- Hyrjet në aftësimet profesionale të papunëve dhe rezultati i aftësimit profesional si masë për të avancuar mundësinë e punësimit për të regjistruarit si të papunë;


PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Numri i përgjithshëm i punëkërkueseve të regjistruar nga shërbimet publike të punësimit (ShPP) deri në fund të vitit 2014 është 274,487 persona, apo te papunët e regjistruar janë 83,323 persona. Të dhënat e paraqitura te punëkërkueseve tregojnë ngritje modeste prej 2.4% për 12 muaj. Mirëpo krahasuar me vitin paraprak, për vitin 2014 kemi një rënie prej 3.4% ne 2.4%.
- Numri i përgjithshëm i punëkërkueseve me nivel të kualifikimit të “pakualifikuar” (ISCED 0-2) është 156,881 persona te regjistruar deri ne fund te vitit 2014 apo te regjistruar sit e papune janë 56,410 persona. Krahasuar me nivele tjera te kualifikimit, situata paraqet një proporcion më të lartë të numrit të përgjithshme të punëkërkueseve (57%) si dhe shkallën në regjistrime krahasuar me vitin paraprak prej 2.1%.
- Numri i përgjithshëm i personave të regjistruar si punëkërkuës në shërbimet publike të punësimit deri në fund të vitit 2014, përbëhej prej 127,921 femrave dhe 146,566 meshkujve. Numri i femrave të regjistruara si punëkërkuese ka rënie prej 4.2% sa ishte ne vitin e kaluar ne 2.9 gjatë vitit 2014, sikurse edhe numri i meshkujve të regjistruar si punëkërkuës ka rënie 2.7% prej 2013 ne 2.0% ne 2014.
- Gjithsejtë 6566 vende te lira te punës janë regjistruar gjate vitit 2014 ne shërbimet publike te punësimit (ShPP). Nëse krahasojmë me 2013 kemi pësuar rënie prej më shumë se - 5.9%.
- Sa u përket zhvillimeve në tregun e punës në Kosovë te ndara sipas sektorit te pronësisë, numri i përgjithshëm i vendeve të lira te punës, iu është referuar sektorit privat. Sipas rezultateve të përgjithshme në vitin 2014 sektori privat ka realizuar rënie të ndjeshme prej -22% krahasuar me vitin paraprak.
- Në vitin 2014 Zyrat e Punësimit kanë realizuar 4667 ndërmjetësime te drejtpërdrejta ne punësim të personave të regjistruar si të papunë. Krahasuar më numrin e përgjithshëm të punësimeve në vitin 2013, ky rezultat paraqet një rënie prej -1.3%
- Ndërmjetësimet ne Punësime sipas sektorëve ekonomik i konfirmojnë zhvillimet që lidhen me vendet e lira te punës te gjetura nga hulumtimi i tregut te punës, i cili behet nga këshilltaret e punësimit. Kështu që në lidhje me punësimet në sektorin terciar (shërbimet) në vitin 2014 paraqesin rënie prej 63.0% sa ishte ne vitin paraprak ne 56.9% ne këtë vit raportues.
- Shkalla e Punësimit tek femrat e papuna është 3.76%. Ndërsa meshkujt arrijnë rezultate prej 7.04% për vitin 2014. Realisht femrat janë nen vlerat e mesatares kosovare e cila është 5.60, kurse meshkujt ne mënyre mbi proporcionale tej kalojnë këto vlera prej 7.04%.
- Sa i përket zhvillimit brenda rajoneve të Kosovës, zyra e punësimit në Prishtinë në vitin 2014 kanë realizuar numrin më të lartë të punësimeve në shifra absolute për periudhën raportuese 12 mujore e cila arrin ne 896 persona apo 19.2%, pasuar nga Prizreni dhe Gjilani me 17.9% (834) respektivisht me 17.5%.

- Gjithsejste 3419 te papune kane hyre ne trajnime gjatë vitit 2014, të shpërndare ne 30 profile te Qendrave te Aftësimit Profesional. Krahasuar me vitin 2013 numri i pjesëmarrësve në Aftësim Profesional është rritur prej 2.1%.
- Qendrat e Aftësimi Profesional edhe gjatë vitit 2014 i kane dhënë rendësi grup moshës se te rinjve qe ne mënyre proporcionale grup moshë 15-24 merr pjesë me 47.1%, pasuar nga grup moshë tjetër 25-39 me 44.8%. Kurse grup moshë 40-54 dhe 55+ marrin pjesë me 7.8% respektivisht me 0.3%.
- Hyrjet për 12 muaj në aftësimet profesionale sipas gjinisë, tregon se përqindja e femrave ne pjesëmarrje është me e mirë krahasuar me vitin paraprak sa ishte prej 45% ndërsa për këtë vit (2014) raportues është 49%. Megjithatë, ngritja e grupit të femrave me rreth 49% është trend pozitiv në raport me pjesëmarrjen e meshkujve prej rreth 51%.
- Zhvillimi i kapaciteteve të aftësimeve profesionale (AP) sipas rajoneve, pasqyron rezultate te ndryshme, rajoni i Prizrenit ne mënyrë proporcionale dominon me 20% ose 693 pjesëmarrës kundrejt rajoneve tjera. Pas këtij rajoni renditet Rajoni i Pejës me 17% ose 583 pjesëmarrës ne trajnime. Rajoni me aktivizimin me te ulte është Prishtina me 11% ose 387 pjesëmarrës, pasojnë rajoni i Ferizajt (397) dhe Mitrovicës (423) me 12%.

1. Punëkërkuessit e regjistruar

Numri i përgjithshëm i punëkërkuessive të regjistruar nga shërbimet publike të punësimit (ShPP) deri në fund të vitit 2014 është 274,487 persona. Të dhënat e paraqitura te punëkërkuessive tregojnë ngritje modeste prej 2.4% për 12 muaj. Mirëpo krahasuar me vitin paraprak, për vitin 2014 kemi një rënie prej 3.4% ne 2.4% ne regjistrime.



Hyrjet 12 mujore te punëkërkuessit e regjistruar (15,108) ka rënie mjaft të lartë prej -16%, krahasuar me rezultatet e vitit 2013 (17,984).

Daljet 12 mujore te punëkërkuessive te regjistruar (8,725) ka treguar rënie te theksuar me më shumë se -5.4% nga viti paraprak (9221).

Tabela 1: Punëkërkuessit e Regjistruar

Përshkrimi	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Hyrjet 12 mujore	21979	19462	19914	20125	24879	17984	15,108
ShH mesatarja mujore	0.55%	0.35%	0.49%	0.50%	0.77%	0.56%	0.46%
Daljet 12 mujore	20632	16509	23549	30124	90799	9221	8,725
ShD mesatarja mujore	0.51%	0.41%	0.58%	0.75%	2.81%	0.29%	0.27%
Rritja 12 mujore	0.4%	0.9%	-1.1%	-3.0%	-20.3%	3.4%	2.4%

Sa u përket shkallës së hyrjeve, pasqyrohet një trend ne rënie e regjistrimeve prej vitit 2013 e cila vazhdon edhe gjate këtij viti. Po ashtu edhe shkalla e daljeve tregon shifra mjaft te ulëta sidomos dy vitet e fundit.¹ Duke treguar një qarkullim të ulët dhe dinamikë të kufizuar të krijimit të vendeve të punës dhe të ri integritit të punëkërkuessive në punësim, shikuar ne përgjithësi Hyrjet janë përafërsisht dyfishi i Daljeve nga tregu i punës për periudhën raportuese.

¹ Ligji per regjistrim dhe evidencen e te papuneve dhe punekerkuessive - neni 10/ Ndërprerja e mbajtjes në evidencë të të papunësuarve dhe punëkërkuessive, 1.7.nuk paraqitet në Zyrat të Punësimit dy (2) herë radhas mbi gjashtë (6) muaj. Zbatimi i këtij Ligji ka stabilizuar gjendjen ne Hyrje dhe Dalje ne tregun e punes, per me shume shih ligjin.

1.2. Regjistrimi i punëkërkuessve sipas kualifikimeve


Numri i përgjithshëm i punëkërkuessve me nivel të kualifikimit të “pakualifikuar” (ISCED 0-2) është 156,881 persona te regjistruar deri ne fund te vitit 2014. Krahasuar me nivele tjera te kualifikimit, situata paraqet një proporcion më të lartë të numrit të përgjithshme të punëkërkuessve (57%) si dhe shkallën në regjistrime krahasuar me vitin paraprak prej 2.1%. Në të njëjtën kohë ky nivel i kualifikimeve prapë paraqet numrin më të lartë të regjistrimeve të reja (6525 persona) shiko (tabela. 2 si dhe fig. 2)

Tabela 2: Regjistrimi i punëkërkuessve sipas kualifikimeve

Kualifikimi	ISCED	Punëkërkuessit Regjistruar	(%)	Hyrjet 12 mujore	Daljet 12 mujore	ShH mesatare mujore	ShD mesatare mujore
Pakualifikuar	0-2	156,881	57	6525	3365	0.35%	0.18%
Gjysme kualifikuar	3	8,949	3	207	190	0.19%	0.18%
Kualifikuar	3a	22,792	8	396	160	0.15%	0.06%
Shkolla e mesme	3c	77,310	28	6111	4032	0.67%	0.44%
Shkolla e lartë	4	1,715	1	64	25	0.31%	0.12%
Universitet	5a+	6,840	2	1805	953	2.31%	1.22%

Po ashtu grupi tjetër i kualifikimit, të papunët në nivelin si “shkollë e mesme” paraqet numrin e madhe ne regjistrime (77,310) persona. Kjo kategori paraqet ngritje te theksuar ne regjistrimin e punëkërkuessve prej 2.8% (ose 6,111 persona) ne raport me vitin paraprak.

Veçanërisht një krahasim proporcional i daljeve sipas kualifikimeve mund të theksojë përveç zbatimit te ligjit edhe relacionin më të drejtpërdrejt të niveleve të kualifikimit dhe riintegrimin e mundshëm në punësim (fig. 2 dhe tabela 2).



Kualifikimet sa me të të larta të jenë “shkollë e mesme” dhe “universitet” përballen me: shkallën më të lartë të hyrjes mesatare mujore si dhe mesataren më të lartë të daljeve mujore, duke treguar dinamikë mbi proporcionale të tregut të punës, përkatësisht rrezik më të ulët për të mbetur të papunë (afat gjatë). Duke pasur kontrast veçanërisht tek punëkërkuessit në tri nivelet më të ulëta të kualifikimit që përbejnë afërsisht 68% e regjistrimeve dhe me një dinamikë të ulët sa i përket trendëve në tregun e punës.

1.3. Punëkërkuessit e regjistruar sipas moshe


Tabela 3: Regjistrimi i punëkërkuessive sipas grup-moshave

Mosha	Punëkërkuessit e regjistruar	(%)	Hyrjet 12 mujore	Daljet 12 mujore	ShH mesatarja mujore	ShD mesatarja mujore
15-24	98,867	36%	5987	3065	0.51%	0.26%
25-39	129,081	47%	6327	4082	0.41%	0.27%
40-54	38,002	14%	2237	1222	0.49%	0.27%
55-64	8,537	3%	557	356	0.55%	0.35%

Sa i përket punëkërkuessive te regjistruar sipas grup-moshës, shumica e tyre (129,081 persona) në shifra të akumuluar ende i referohen moshës prej 25-39 vjeçar ose 47%.

Sikurse në vitet paraprake presioni më i lartë sa i përket regjistrimeve te punëkërkuessive është prapë grupi më i ri për nga mosha, në veçanti sa i përket rritjes në regjistrime me 3.0%, (shiko tabelën 3 dhe fig. 3).

Ne përgjithësi duke shikuar tendencat e përgjithshme, mirëpo duke e konfirmuar sipas rezultateve të vitit 2014, punëkërkuessit e moshave 25-39 pastaj 40-54 si dhe 55-64 vjeçar tregojnë një rritje në regjistrime, e cila është (1.8%, 2.7% dhe 2.4%) në vitin 2014.



1.4. Punëkërkuessit e regjistruar sipas etnitetit

Sa i përket qasjes së minoriteteve në shërbimet publike të punësimit, regjistrimet e punëkërkuessive sipas minoriteteve janë prioritet i veçantë.

Tabela 4: Punëkërkuessit e regjistruar sipas etnitetit

Etniteti	Punëkërkuessit e regjistruar	Proporcioni (%)	Hyrjet 12 mujore	Daljet 12 mujore	ShH mesatarja mujore	ShD mesatarja mujore
Shqiptar	245,541	89%	13360	7632	0.46%	0.26%
Serbë	13,179	5%	811	497	0.52%	0.32%
Minoritetet	15,767	6%	937	596	0.50%	0.32%
Gjithë Minoritetet	28,946	11%	1748	1093	0.51%	0.32%


Shkalla e regjistrimeve te punëkërkuessive gjate vitit 2014 paraqet rezultate ne ngritje për te gjithë te regjistruarit si punëkërkuess.

Të komuniteti serb shifrat tregojnë një rritje modeste prej 2.4% njëjtte sikurse për shumicën shqiptare 2.4%, derisa serbe te regjistruar si punëkërkuës janë 13179 persona, ose ne forme proporcionale janë 5%. Shumica shqiptare ne mënyrë proporcionale te regjistrimi i punëkërkueseve merr pjese me 89%. Po ashtu te gjitha minoritetet e regjistruara marrin pjesë me 2.3%, në regjistrime si punëkërkuës ose ne mënyrë proporcionale me 11%.

Minoritetet arrijnë rezultate te ngjashme proporcionale sa i përket shkallës mesatare të hyrjeve mujore (shih. tab. 4 dhe fig. 4).

Në një aspekt shkallët me te larta te Hyrjes/Daljes ne krahasim me shqiptaret, në formë pozitive tregojnë progresin e vazhdueshëm në përfshirjen e minoriteteve dhe në veçanti pranimin në shkallë të gjerë të shërbimeve të ofruara.

Në anën tjetër, minoritetet përballen me vlera te pa baraspeshuara në dalje nga papunësia. Ndryshe nga periudhat e mëparshme raportuese, në vitin 2014 shkalla e daljes përkatëse prej 0.32% është madje mbi rezultatet e arritura nga mesatarja kosovare qe është 0.27% (tab. 4, krahasoni Raportin Vjetor DPP 2013 ose Informatën e Tregut te Punës, Dhjetor 2014).




1.5. Punëkërkuësit e regjistruar sipas gjinisë

Numri i përgjithshëm i personave të regjistruar si punëkërkuës në shërbimet publike të punësimit deri në fund të vitit 2014, përbëhej prej 127,921 femrave dhe 146,566 meshkujve.

Shkalla e femrave të regjistruara si punëkërkuëse ka rënie prej 4.2% sa ishte ne vitin e kaluar ne 2.9 gjatë vitit 2014, sikurse edhe numri i meshkujve të regjistruar si punëkërkuës ka rënie 2.7% prej 2013 ne 2.0% ne 2014.

Përshkrimi	2012		2013		2014	
	Femra	Mashkuj	Femra	Mashkuj	Femra	Mashkuj
Shkalla Mujore e Hyrjeve	0.70%	0.83%	0.58%	0.55%	0.45%	0.47%
Shkalla Mujore e Daljeve	3.29%	2.40%	0.24%	0.33%	0.22%	0.31%
Rritja 12 Mujore	-38548	-27372	4995	3768	3552	2831
Shkalla e Rritjes 12 mujore	-24.4%	-16.4%	4.2%	2.7%	2.9%	2.0%
Punëkërkuës te regjistruar	119374	139967	124369	143735	127921	146566
Proporcioni (%)	46.0%	54.0%	46.4%	53.6%	46.6%	53.4%
Rritja 12 mujore e të pakualifikuarave	-27.7%	-18.6%	4.0%	2.5%	2.6%	1.4%
Punëkërkuësit të pakualifikuarve	82260	66489	85557	68164	87747	69134
Proporcioni i të "pakualifikuarve"	55.3%	44.7%	55.7%	44.3%	55.9%	44.1%
Rritja 12 mujore e 15-24	-12.7%	-14.4%	4.1%	3.1%	3.6%	2.5%
Punëkërkuësit e regjistruar 15-24	46423	46192	48338	47607	50058	48809
Proporcion 15-24	50.1%	49.9%	50.4%	49.6%	50.6%	49.4%

Megjithatë, zbrazëtia e gjithmbarshme gjinore është me vlerë te theksuar me 0.9 pika përqindjeje (pp) në shkallën e rritjes.



Dy grupet ne fokus, te rinjtë dhe te pakualifikuarit paraqesin te dhëna ndryshe shikuar ne aspektin e gjinisë. Sa i përket shifrave të meshkujve të të njëjtit grup moshe (15-24) tregojnë rënie prej 3.1% sa ishte ne vitin e kaluar ne 2.5% gjate këtij viti. Ndërsa femrat e punëkërkuese (15-24) më moshë te re, në vitin 2014 kjo kategori tregon një shkallë te rënies prej 4.1% ne 3.6%.

Ndërsa te pakualifikuarit ndërmjet gjinive paraqesin te dhëna ndryshe, ku femrat kane pësuar rënie prej 4.0% sa ishte ne vitin e kaluar ne 2.6% për vitin 2014, po ashtu meshkujt e pakualifikuar kane pësuar rënie ku ne vitin 2013 ishte 2.5% ndërsa tani për vitin 2014 është -1.4%.

1.6. Zhvillimet Rajonale


Tabela 6a: Shkallët e Hyrjes/Daljes / Regjistrimet

Rajonet 2013	Shkalla e Hyrjes %		Shkalla e Daljes %		Punëkërkuessit e regjistruar
	Mesatarja mujore	Kumulativi 12-mujor	Mesatarja mujore	Kumulativi 12-mujor	
Ferizaj	0.49%	5.82%	0.32%	3.89%	31641
Gjakovë	1.06%	12.77%	0.87%	10.42%	14664
Gjilan	0.55%	6.60%	0.30%	3.64%	30672
Mitrovicë	0.33%	3.96%	0.16%	1.95%	55065
Pejë	0.82%	9.81%	0.49%	5.84%	19282
Prishtinë	0.63%	7.58%	0.21%	2.55%	68061
Prizren	0.55%	6.60%	0.26%	3.08%	48719

Tabela 6: Shkallët e Hyrjes/Daljes / Regjistrimet

Rajonet 2014	Shkalla e Hyrjes %		Shkalla e Daljes %		Punëkërkuessit e regjistruar
	Mesatarja mujore	Kumulativi 12-mujor	Mesatarja mujore	Kumulativi 12-mujor	
Ferizaj	0.43%	5.13%	0.23%	2.76%	32402
Gjakovë	0.87%	10.49%	0.71%	8.53%	14956
Gjilan	0.52%	6.21%	0.36%	4.32%	31259
Mitrovicë	0.27%	3.28%	0.13%	1.55%	56026
Pejë	0.71%	8.55%	0.58%	6.93%	19598
Prishtinë	0.44%	5.30%	0.15%	1.86%	70452
Prizren	0.47%	5.66%	0.29%	3.48%	49794

Përsëri ne vitin 2014 numri më i lartë i punëkërkuessive te regjistruar mbetet Prishtina me 70,452 persona, pas kësaj qendre numri me i madhe i punëkërkuessive te regjistruar i referohet zyrave të punësimit në rajonin e Mitrovicës me 56,026 persona (shih tabela 6). Shkalla më e lartë e ngritjes në regjistrime te punëkërkuessive në vitin 2014 i referohet rajonit të Gjakovës me 8.53%, i cila gjithashtu përballet me Shkallen e Hyrjes (ShH) prej 10.49%. Përkundër kësaj, dalja relative nga regjistrimet (shkalla e daljes) brenda rajonit të Mitrovicës paraqet rezultatet prej me të ulëtave krahasuar me te gjitha rajonet tjera ne përjashtim te Prishtinës (1.55% respektivisht 1.86%, shih tab.6). Duke parë kontrastin që të punëkërkuessit në rajonin e Mitrovicës dhe Prishtinës kanë treguar rezultatet shumë më të ulëta se rajonet tjera, duke u përballur me dalje mesatare mujore prej (vetëm) 0.13% respektivisht 0.15%.




1.7. Kapacitetet rajonale dhe shkalla e punëkërkuessve sipas stafit

Tabela 7: Shkalla e punëkërkuessve te regjistruar sipas proporcionit të stafit

Rajonet	Punëkërkuessit e regjistruar	Shkalla e punëkërkuessve sipas stafit	Hyrjet sipas stafit	Daljet sipas stafit
Ferizaj	32402	1705:1	87:1	47:1
Gjakovë	14956	712:1	74:1	60:1
Gjilan	31259	1042:1	64:1	45:1
Mitrovicë	56026	2155:1	70:1	33:1
Pejë	19598	980:1	84:1	68:1
Prishtinë	70452	1677:1	88:1	31:1
Prizren	49794	2075:1	116:1	72:1
Gjithsejte	274,487	1508:1	83:1	48:1

Me qëllim të mbështetjes së indikatorëve te performances, duke analizuar dhe krahasuar rezultatet, duhet pasur parasysh dallimet e kapaciteteve rajonale te cilat nuk janë te njëjta. Shërbimit Publike te Punësimit ne përgjithësi kane afërsisht 182 zyrtar rajonal për punësim (pa përfshirë këtu stafin mbështetës) te cilët është dashur të kujdesen për 274,487 punëkërkuess. Duke rezultuar në punëkërkuess për staf prej 1508:1.



Qendra rajonale për punësim në rajonin e Mitrovicës vazhdimisht pësojnë nga punëkërkuessit më te lartë (më e keqe) për staf, ndjekur nga zyrtar në rajonin e Prizrenit dhe Ferizajt. Rajonet me shkallën më të ulët (më të mirë) të punëkërkuessve për staf në vitin 2014 janë Gjakova Peja (tab. 7). Gjilani, Mitrovica dhe Gjakova përballen me Hyrjet e reja ne papunësi për staf në shkallë pakëz nen-proporcionale (64:1,70:1 dhe 74:1).

Zyrtar e punësimit ne rajonin e Prishtinës, Mitrovicës, Gjilanit dhe Ferizajt janë nen mesataren e Daljeve ne Kosove (31:1, 33:1,45:1 dhe 47:1) (shih fig 7 dhe tab,7).

Mirëpo zyrtar ne rajonin e Prizrenit, Pejës dhe Gjakovës tregojnë rezultatin me te madhe te daljeve prej 72:1, 68:1 dhe 60:1 për staf për vitin 2014.

2. Papunësia e regjistruar

Numri i përgjithshëm i te papunëve te regjistruar nga shërbimet publike te punësimit deri ne fund te vitit 2014 është 83,320 persona. ku prej tyre femra janë 36,570 ndërsa mashkuj 46,753 persona.

Përshkrimi	Gjithsejte	Femra	Mashkuj
Papunësia e regjistruar "2013"	74,475	32,327	42,148
Hyrje 12 mujore	8,848	4,243	4,605
Papunësia e regjistruar "2014"	83,323	36,570	46,753
Rritja 12 mujore (%)	11.9%	13.1%	10.9%

Hyrjet ne papunësi për 12 muaj tregon rritje afërsisht prej 11.9% duke krahasuar me numrin e te regjistruarave nga viti paraprak (2013), po ashtu sikurse femrat edhe mashkujt janë rritur ne regjistrime prej 13.1% përkatësisht 10.9%.

2.1. Papunësia sipas kualifikimeve

Niveli i Kualifikimit	ISCED	Papunësia	(%)	Femra	Mashkuj
Pa-kualifikuar	0-2	56,410	67.7%	25924	30486
Gjysme Kualifikuar	3	3,127	3.8%	1463	1664
Kualifikuar	3a	8,277	9.9%	3555	4722
Shkolle e mesme	3c	12,678	15.2%	4099	8579
Shkolle e larte	4	320	0.4%	107	213
Universitet	5a+	2,511	3.0%	1422	1089
Gjithsejte		83,323	100%	36,570	46,753

Numri i përgjithshëm i te papunëve te regjistruar si te "Pakualifikuar" është 56,410 persona ose 67.7%, ndërsa te papunët e regjistruar me "sh.mesme" arrijnë shifrën prej 12.678 persona ose 15.2% si dhe te "kualifikuar" me 8,277 ose 9.9%.

Ndërsa numri i te regjistruarave me arsim te larte mbete ne shifra modeste, duhet theksuar te regjistruarit me universitet qe është 3.0% ose 2.511 persona, mandej shkollë të lartë me 0.4% ose 320 persona.

2.2. Papunësia sipas moshe

Papunësia e regjistruar sipas grup moshave me se shumti i referohet moshës prej 25-39 vjeçar me 49.5%, pastaj grup mosha 40-54 merr pjese me 31.9% ne papunësi te regjistruar. Grup mosha e te rinjve 15-24 dhe me te vjetërve 55-64 marrin pjese me 9.3% e regjistrimeve.

Grupë mosha	Totali	%	Femër	Mashkull
15 - 24	7741	9.3%	3803	3938
25 - 39	41231	49.5%	18409	22822
40 - 54	26561	31.9%	11152	15409
55+	7790	9.3%	3206	4584
Total	83,323	100%	36570	46753

Regjistrimi i papunësisë për te rinjtë me vetëm 9.3%, ndoshta tregon qe një numër i madhe prej tyre, vazhdojnë arsimin e lartë duke mos qenë pjesë aktive e tregut të punës.

2.3. Papunësia sipas etniteteve

Përshkrimi	Totali	%	Femër	Mashkull
Shqiptar	72908	87.5%	31929	40979
Serb	3395	4.1%	1560	1835
Minoritete tjera	7020	8.4%	3081	3939
Gjithë Minoritetet	10415	12.5%	4641	5774
Gjithsejte	83323	100.0%	36570	46753


Shërbimit Publike te Punësimit si duket kane pasur një tretman te veçantë për minoritetet, pasiqe përqindja e regjistrimeve ne papunësi është mjaft modeste, ku minoritete marrin pjesë në mënyrë proporcionale me 8.4%, ndërsa serbet marrin pjese me 4.1% ose te gjithë minoritetet me 12.5%. Përsëri shumica shqiptare arrijnë shifra dominuese me 87.5% ne regjistrimin e papunësisë.

2.4. Papunësia sipas rajoneve

Rajoni	Papunësia	%	Femër	Mashkull	Shkalla e papunësisë sipas stafit
Ferizaj	11,339	14%	5,182	6,157	597:1
Gjakovë	7,621	9%	3,398	4,223	363:1
Gjilan	11,357	14%	5,202	6,155	379:1
Mitrovicë	12,800	15%	5,153	7,647	492:1
Pejë	7,212	9%	3,255	3,957	361:1
Prishtinë	17,990	22%	7,453	10,537	428:1
Prizren	15,004	18%	6,927	8,077	625:1
Total	83,323	100%	36,570	46,753	458:1

Numri më i lartë i të papunëve është regjistruar në Prishtinë me 17,990 persona ose në mënyrë proporcionale me 22%, pastaj Prizreni me 18% ose 15,004 persona si dhe Mitrovica me 15% ose 12800 persona.

Rajoni i Pejës dhe Gjakovës përballen me numrin më të vogël të regjistrimeve me vetëm 9% ose (7.212, përkatësisht 7621) persona të regjistruar si të papunë.




Shërbimit Publike të Punësimit me një staf prej afërsisht 182 zyrtarëve është dashur të ofrojnë shërbime për 83,323 persona të regjistruar si të papunë. Numri më i madhe i të papunëve për staf është realizuar në rajonin e Prizrenit me 625:1, pastaj Ferizajt me 597:1. Ndërsa me papunësinë më të ulte për staf është përballur rajoni i Pejës dhe Gjakovës me 361:1 respektivisht me 363:1.

3. Vendet e lira te punës

Duke marrë në shqyrtim procedurat e shërbimit publik për punësim (ShPP) në përgjithësi, detyra e tyre kryesore është e fokusuar në regjistrimin e të papunëve me qëllim të riintegrit të tyre në punësim dhe aftësim profesional.

Te papunësuarit : - Pas regjistrimit ne Sistemin Informativ te Menaxhimit te Punësimit, hapi tjetër nënkupton të këshillohen me qëllim të punësimit në të ardhmen dhe/apo orientimit ne karriere. Nëse është e nevojshme të përshtatet një orientim për tregun e punës, do të vihet në




mes një aftësim/trajnim profesional ndërmjet, në mënyrë që të fitohen kualifikimet e kërkuara.

Punëdhënësit: - Objektivi për ti dërguar te papunët në punësim është i bazuar në krijimin e suksesshëm të vendeve të lira te punës, si dhe përshtatjen në mënyrë të duhur të të papunëve, siç ofron personeli me kërkesën e raportuar. Kjo procedurë zakonisht quhet *Ndërmjetësim i Punësimit*: Punëdhënësit e kontaktuar krijojnë vendet e lira te punës (kërkesa për fuqi punëtore) dhe sjellin te papunët (furnitorët e fuqisë punëtore). Aq sa është e mundur, rezultati i kësaj procedure do të ilustruhet në kapitullin në vijim.

3.1. Vendet e Lira


Gjithsejtë 6566 vende te lira te punës janë regjistruar gjate vitit 2014 ne shërbimet publike te punësimit (ShPP). Nëse krahasojmë me 2013 kemi pësuar rënie prej më shumë se -5.9%.



Duke iu referuar numrit të personave që janë regjistruar si te papune, numri i vendeve të lira të krijuara rezulton në shkallë regjistrimi të vendeve të lira (ShRVL) prej 7.9% në vitin 2014.

Brenda një periudhe 12 mujore, ka qenë një vend i lirë në dispozicion për rreth 13 te papunë. Duke pasur parasysh mesataren mujore atëherë do të kemi një përshtypje më realiste për situatën. Sipas statistikave çdo muaj më shumë se 152 te papunë është dashur të konkurrojnë për 1 vend të lirë pune të ofruar.

3.2. Vendet e lira sipas Sektorit




Gjate vitit 2014, sa i përket *klasifikimit klasik* të sektorëve ekonomik, sikur në vitet e mëparshme, shumica e vendeve të lira të ofruara i referohen sektorit *terciar* (shërbimet, 63%), ndjekur nga *sektori sekondar* (prodhimi, 22%) dhe *sektori primar* (bujqësia, 15%).

Sektori terciar tregon një rënie modeste ne numrin e vendeve te lira te punës te raportuara gjate kësaj periudhe raportuese prej 70% sa ishte ne vitin 2013 ne 63% ne vitin 2014. Ndërsa sektori

sekondar tregon vlera modeste te rritjes prej 21% sa ishte ne vitin 2013 ne 22% gjatë këtij viti 2014. Kurse sektori primar tregon ngritje prej 9% sa ishte ne vitin e kaluar ne 15% për vitin 2014.

Sektori i shërbimeve (terciar), ne vazhdimësi sikurse ne periudhat e mëhershme raportuese, po ashtu edhe në vitin 2014 ka realizuar vlerat maksimale në kërkesën e përgjithshme (shiko fig.11).



Sa u përket zhvillimeve në tregun e punës në Kosovë te ndara sipas sektorit te pronësisë, numri i përgjithshëm i vendeve të lira te punës, iu është referuar sektorit privat. Sipas rezultateve të përgjithshme në vitin 2014 sektori privat ka realizuar rënie të ndjeshme prej -22% krahasuar me vitin paraprak.

Ndërsa sektori publik ka shënuar ngritje prej 49% krahasuar me vitin paraprak (shih fig.12). Mirëpo me rendësi është se ne mënyrë proporcionale vendet e lira te punës ne sektorin privat janë 64% krahasuar me sektorin publik prej 36%.


3.3. Vendet e Lira sipas Kualifikimeve

Tabela 13: Vendet e lira të regjistruara sipas kualifikimeve

Kualifikimet	ISCED	Të mbledhur për 12 muaj	%	ShVLR 2014
Pakualifikuar	0-2	2130	32.4%	3.8%
Gjysmë-kualifikuar	3	153	2.3%	4.9%
Kualifikuar	3a	196	3.0%	2.4%
Shkolla e mesme	3c	3196	48.7%	25.2%
Shkolla e lartë	4	10	0.2%	3.1%
Universitet	5a+	881	13.4%	35.1%

Duke analizuar vendet e lira sipas kualifikimeve paraqiten disa ndryshime krahasuar me rezultatin e vitit te mëparshëm.

Në disproporcion me vitet tjera, në vitin 2014 numri më i lartë i vendeve të lira te punës i referohet nivelit të kualifikimeve “sh.mesme” me 49%, duke u pasuar prej vendeve të lira te punës si të “pa kualifikuar” me 32% si dhe me universitetet me 13%. Mirëpo numri më i vogël i vendeve të lira është regjistruar sipas kualifikimit me shkolle të larte me vetëm 0.2% ose krejtësisht 10 vende të lira. Po ashtu kualifikimi gjysme kualifikuar ka regjistruar afërsisht 153 vende të lira ose 2.3%.



Shkalla e vendeve të lira ju referohet vendeve të lira me Universitetet me 35.1%, pastaj shkolle e mesme 25.2%, ndërsa kualifikimet tjera janë shumë më të ulëta.


3.4. Vendet e Lira sipas Rajoneve

Tabela 14: Vendet e lira te regjistruara sipas Rajoneve

Rajonet	Vendet e lira	%	Ndryshimi me 2013	Papunësia	ShVLS 2014	ShVLR 2014
Ferizaj	645	10%	3.9%	11,339	34:1	5.7%
Gjakovë	774	12%	-8.2%	7,621	37:1	10.2%
Gjilan	981	15%	15.8%	11,357	33:1	8.6%
Mitrovicë	937	14%	31.4%	12,800	36:1	7.3%
Pejë	1298	20%	55.4%	7,212	65:1	18.0%
Prishtinë	1074	16%	-56.1%	17,990	26:1	6.0%
Prizren	857	13%	26.6%	15,004	36:1	5.7%


Duke bërë një përmbledhje përfundimtare të vendeve të lira sipas rajoneve paraqiten rezultate të dy anshme në rënie dhe në ngritje përkatësisht në krijimin e vendeve të lira te punës në tërë Kosovën.

Në krahasim me rajonet tjera, shkalla më e lartë e regjistrimit të vendeve të lira



(ShRVL) në vitin 2014 ishte raportuar nga zyrat e rajonit të Pejës (18.0%), Gjakovës (10.2%) dhe Gjilanit (8.6%).

Derisa rajoni i Prizrenit (5.7%), Prishtinës (6.0%) dhe Mitrovicës (7.3%) në vitin 2014 janë përballur me rënien më të ulët sa u përket vendeve të lira të ofruara.



Me fjalë tjera derisa në rajonin e Prishtinës në mesataren mujore sipas statistikave rreth 787 punëkërkuës është dashur të konkurrojnë për 1 vend të lirë të ofruar, ky relacion ishte rreth 181-me-1 në rajonin e Pejës².


Duke pasur parasysh kapacitetet e ndryshme për shërbime që ofrojnë Zyrat e Punësimit, shkalla e regjistrimeve të vendeve të lira (ShRVL-a) dhe numri më i lartë i vendeve të lira në raport me stafin përkatësisht (ShVLS) në vitin 2014 ishte arritur nga zyrtarët e punësimit në rajonin e Pejës (65:1) duke pasuar nga Gjakova (37:1).

Ngjashëm me rezultatet e ShRVL-në, performanca më e ulët sa i përket ShVLS i referohet zyrtarëve të punësimit në rajonet e Prishtinës (26:1) dhe Gjilanit (33:1), (shiko tabelën 9 dhe fig. 15).

² Informata e Tregut të Punës në Kosovë, Dhjetor 2014, DPP/MPMS, faqe 4.

4. Punësimet e ndërmjetësuar

Promovimi i Punësimit mund të merret si indikator më i rëndësishëm sa u përket të gjitha aktiviteteve të realizuara në tregun e punës.



Ndërmjetësimet ne punësimet, përfaqësojnë objektivat kryesore të shërbimeve publike të punësimit në Kosovë, integrimin në tregun e punës dhe sjellja e të papunëve në punësim.

Në vitin 2014 Zyrat e Punësimit kanë realizuar 4667 ndërmjetësimet te drejtpërdrejta ne punësim të personave të regjistruar si të papunë. Krahasuar më numrin e përgjithshëm të punësimeve në vitin 2013, ky rezultat paraqet një rënie prej -1.3% (shiko fig. 16).


Shkalla e punësimit ne raport me vendet e lira arrin shifrën prej 71%, duke iu referuar numrit të punësimeve të realizuara me rezultatet e numrit te vendeve të lira të raportuara. Kështu që nëse shikojmë vitin paraprak kemi një ngritje të lehtë prej 68% sa ishte në vitin 2013 ne 71% për këtë vit raportues.

Tabela 15: Shkalla e Punësimit

Përshkrimi	2014
Papunësia	83,323
Vendet e lira te punës	6,566
Punësimet	4,667
ShPVL	71%
Shkalla Punësimit	5,6%


Në aspektin afatgjatë ShPVL-ja aktuale tregon një sukses të vazhdueshëm dhe të dukshëm në procedurat e përshtatjes së zyrave të punësimit.

4.1. Punësimet sipas Sektorit



Ndërmjetësimet ne Punësimet sipas sektorëve ekonomik i konfirmojnë zhvillimet që lidhen me vendet e lira te punës te gjetura nga hulumtimi i tregut te punës, i cili behet nga këshilltaret e punësimi. Kështu që në lidhje me punësimet në sektorin terciar (shërbimet) në vitin 2014 paraqesin rënie prej 63.0% sa ishte ne vitin paraprak ne 56.9% ne këtë vit raportues.

Sektorin sekondar (prodhimi) ka rënie te theksuar nga viti paraprak prej 23.0% ne 20.2% gjate vitit 2014. Mirëpo pjesa e të gjitha punësimeve që i referohen sektorit primar gjate këtij viti raportues tregojnë vlera në ngritje prej 14.0% sa ishte ne vitin 2013 ne 22.9% për vitin 2014 (shih fig.17).



Punësimet ne sektorët sipas pronësisë në vitin 2014 prapë korrespondojn ne vlera krahasuese ndërmjet dy sektorëve. Gjate vitit raportues pjesa e të gjitha ndërmjetësimeve ne punësimet që i referohet sektorit publik ka ngritje te madhe prej 43% krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa, ekonomia e sektorit privat në të njëjtën kohë ka absorbuar gati 74% të të gjitha punësimeve të realizuara, mirëpo krahasuar me vitin 2013 rënia është po ashtu e madhe deri ne -17%. (shiko fig. 18).


4.2. Punësimet sipas Kualifikimeve

Tab. 16: Punësimet e ndërmjetësuar sipas kualifikimeve

Punësimet	ISCED	Punësimi	%	Papunësia	Shkalla Punësimit
Pakualifikuar	0-2	1911	40.9%	56,410	3.4%
Gjysmë-kualifikuar	3	137	2.9%	3,127	4.4%
Kualifikuar	3a	80	1.7%	8,277	1.0%
Shkollë e mesme	3c	2009	43.0%	12,678	15.8%
Shkollë e lartë	4	16	0.3%	320	5.0%
Universitet	5a+	514	11.0%	2,511	20.5%

Numri më i lartë i ndërmjetësimeve në punësim është arritur me shkollë të mesme me 43.0%, pastaj pakualifikuar me 40.9% dhe Universitet me 11%. Kualifikimet tjera kanë treguar përqindje më të ulte të punësimit dhe atë, në vlera tejet të vogla.

Duke iu referuar punësimeve të realizuara për vendet e lira të raportuara, atëherë vihet në dukje se veçanërisht rezultatet e larta janë arritur (ShP) për nivelin e kualifikimeve “Universitet” dhe “shkollë të mesme”. Ndërsa në mesataren



kosovare prej 5.6%, kanë pësuar të “pa-kualifikuarit”, dhe “kualifikuarit” në raport me kualifikime tjera.

Mirëpo besohet se disa programe të vogla të punësimit gjegjësisht punëve publike janë faktori kryesor i këtij disbalanci të punësimeve dhe rritjes së vendeve të lira të punës. Kryesisht të bazuara në arsye tekniko-administrative, apo në progres në performancën e përshtatjes.

Sa i përket nivelit të kualifikimit “universitet”, duket se vazhdimisht mbetet një ofertë e limituar (furnizim me fuqi punëtore) relative me kërkesën (vendet e lira). Siç është përmendur tashmë në raportet paraprake, situata vë në dukje një nevojë të madhe për përshtatje adekuate të kualifikimeve konkrete, me qëllim të përmirësimit të mëtutjeshëm të mundësisë së përshtatshme për punësimin e këtij grupi.

4.3. Punësimet sipas Moshës


Tab. 17: Punësimet e regjistruara sipas grup-moshave

Grup-mosha	Punësimi për 12 Muaj	%	Papunësia	Shkalla Punësimi
15-24	1,353	29.0%	7,741	17.48%
25-39	2,389	51.2%	41,231	5.79%
40-54	819	17.5%	26,561	3.08%
55+	106	2.3%	7,790	1.36%
Gjithsejte	4,667	100.0%	83,323	5.60%

Sipas rezultateve të përgjithshme në vitin 2014, shkalla e punësimi (ShP) është arritur për grupin e të rinjve (15-24) me 17.48%, pasuar nga grup moshë (25-39) me 5.79%, ndërsa dy grup moshat tjera (40-54 dhe 55+) kanë treguar rezultate me të ulëta me 3.08% respektivisht me 1.36% (shih. fig.21).

Me fjalë tjera, numri më i madhe i të punësuarave në mënyrë proporcionale shkon për grup moshën 25-39 me 51.2%, pastaj për grup moshën 15-24 me 29.0%, ndjekur nga dy grup moshat tjera 40-54 me 17.55 dhe 55+ me 2.3%.

Derisa grupet më të vjetra duhet të llogarisin në përpjekjet e veta, më shumë me qëllim të realizimit në mënyrë të suksesshme ri-integrimit në tregun e punës, ky zhvillim duket se konfirmon varshmërinë e lartë të të papunëve më të rinj në masat aktive të punësimi.




4.4. Punësimet sipas Etnitetit

Tabela 18: Papunësia sipas etniteteve

Etniteti	Punësimi	%	Papunësia	Shkalla e Punësimi
Shqiptar	4025	86%	72908	5.52%
Serb	290	6%	3395	8.54%
Minoritete tjera	352	8%	7020	5.01%
Gjithë Minoritetet	642	14%	10415	6.16%
Gjithsejte	4667	100.0%	83323	5.60%

Ne total ndërmjetësimi ne punësim te realizuara nga Shërbimit Publike te Punësimit për 12 muaj janë 4667 persona, mirëpo mënyra proporcionale shkon për shqiptaret me 86% ose 4025 te punësuar, kurse te gjitha minoritetet marrin pjese me 14% ose 642 ndërmjetësime ne punësim. Mirëpo ne mënyrë te veçantë, ne përjashtim te komuniteteve tjera pakicë serbet marrin pjese me 6% ose 290 ndërmjetësime ne punësim.

Sa i përket relacionit të punësimeve dhe papunësisë se regjistruar, shqiptarët e Kosovës realizojnë shkallën e punësimit për 12 muaj (ShP) prej më shumë se 5.52%, gjë e cila është pakëz nene rezultatet e arritura në mesataren kosovare, po ashtu minoritetet tjera (jo serbe) gjatë kësaj periudhe raportojnë nen mesataren kosovare me 5.01% te shkallës se punësimit (shih. tab. 13 dhe fig. 22).



Rezultatet e arritura për serbët e Kosovës edhe gjatë vitit raportues (2014) janë mbi mesataren kosovare me 8.54% (shih tab. 13, fig. 22), gjë e cila shihet qartë se punësimet për këtë komunitet janë me lartë se shqiptaret (5.52% përkatësisht 8.54%). Këto shifra janë te larta, sigurisht edhe si rezultat i programeve dhe projekteve te ndryshme. Pra komuniteti serb arrin shkallen ne punësim prej 8.54% qe është me e madhe nga te gjitha komitetet tjera dhe nga shqiptaret shumicë qe janë me 5.52%.

4.5. Punësimi sipas Gjinisë

Shërbimet Publike te Punësimit kane realizuar 29.5% e ndërmjetësimeve për gjininë femërore ose 1.376 persona, ndërsa mashkujte janë ndërmjetësuar me 70.5% ose me 3.291 persona.

Tabela 19: Punësimet sipas gjinisë

	Femra	Mashkuj	Total
Papunësia	36,570	46,753	83,323
Punësimet	1,376	3,291	4,667
ShP	3.76%	7.04%	5.60%
Proporcioni	29.5%	70.5%	100%

Shkalla e Punësimit tek femrat e papuna është 3.76%. Ndërsa mashkujte arrijnë rezultate prej 7.04% për vitin 2014. Realisht femrat janë nen vlerat e mesatares kosovare e cila është 5.60%, kurse mashkujte ne mënyrë mbi proporcionale tej kalojnë këto vlera prej 7.04%.

4.6. Punësimet sipas Rajoneve

Tabela 20: Punësimet e ndërmjetësuar sipas rajoneve					
Rajonet	Punësimet 12-Mujore	%	Papunësia	Shkalla Punësimit	ShPS
Ferizaj	331	7.1%	11,339	2.9%	17:1
Gjakovë	664	14.2%	7,621	8.7%	32:1
Gjilan	815	17.5%	11,357	7.2%	27:1
Mitrovicë	421	9.0%	12,800	3.3%	16:1
Pejë	706	15.1%	7,212	9.8%	35:1
Prishtinë	896	19.2%	17,990	5.0%	21:1
Prizren	834	17.9%	15,004	5.6%	35:1
Gjithsejte	4667	100%	83,323	5.60%	26:1



Sa i përket zhvillimit brenda rajoneve të Kosovës, zyra e punësimit në Prishtinë në vitin 2014 kanë realizuar numrin më të lartë të punësimeve në shifra absolute për periudhën raportuese 12 mujore e cila arrin në 896 persona apo 19.2%, pasuar nga Prizreni dhe Gjilani me 17.9% (834) respektivisht me 17.5% (815).

Numri më i ulët i punësimeve ishte raportuar nga rajoni i Ferizajit me 331 ndërmjetësime në punësim me vetëm 7.1% ose 331 persona të ndërmjetësuar (shih. tab 15

Shkalla më e lartë e punësimeve brenda rajoneve në Kosovë është regjistruar në rajonin e Pejës me 9.8%, pasuar nga rajoni i Gjakovës me 8.7% dhe Gjilanit me 7.2%. Rajoni i Ferizajit dhe Mitrovicës përballen me shkallën më të ulët prej 2.9% respektivisht 3.3%.

Zyrtarët e punësimit në rajonin e Mitrovicës realizojnë shkallën më të


ulët të punësimeve për staf (ShPS 16:1), ndjekur nga rajoni i Ferizajit dhe Prishtinës (ShPS 17:1 dhe 21:1). Performanc shumë më të mirë rajonale për vitin 2014 sa i përket ShPS-së ishte raportuar nga zyrtarët e punësimit në rajonet e Pejës, dhe Prizrenit (35:1).



5. Aftësimi Profesional

Divizioni i Aftësimeve e Profesionale (DAP) menaxhohet nga Departamenti i Punës dhe Punësimi (DPP) i cili njëkohësisht menaxhon edhe Divizionin e Punësimi (DP), i cili është përgjegjës për Informimin, regjistrim, këshillim, orientim ne karrierë dhe ndërmjetësim ne punësim.

Objektivi i Divizionit te Aftësimeve Profesionale është të mbështesë mundësinë e punësimi të papunëve te regjistruar. Për të arritur këtë, DAP-ja ka një rrjet prej tetë (8) Qendrave Rajonale për Aftësim Profesional (QAP) dhe koordinon kapacitetet e aftësimi profesional të institucioneve jo publike për aftësim profesional.



Gjithsejste 3419 te papune kane hyre ne trajnime gjatë vitit 2014, të shpërndarë ne 30 profile te Qendrave te Aftësimi Profesional. Krahasuar me vitin 2013 numri i pjesëmarrësve në Aftësim Profesional është rritur prej 2.1%.

Duke iu referuar numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve në AP (përkatësisht hyrjet) në vitin 2014 me numrin mesatar i të regjistruarve si punëkërkues në këtë kohë, rezulton në shkallë aktivizimi 12 mujore (ShA) prej rreth 1.26%, duke mbetur konstant me vitin paraprak.

Duke iu referuar numrit të akumuluar të hyrjeve në vitin 2014, numri i të çertifikuarve nga AP-ja (2150), rezulton në shkallë çertifikimi (ShÇ) prej rreth 63%, duke treguar ngritje relative nga ShÇ prej 62% në vitin paraprak.

5.1. Aftësimi sipas Kualifikimeve


Tabela 16: Aftësimet Profesionale sipas Kualifikimeve

Aftësimet	ISCED	Akumulimi 12-Mujor	%	Papunësia	ShA 2014	ShÇ 2014
Pakualifikuar	0-2	975	29%	56,410	1.7%	90%
Gjysmë kualifikuar	3	8	0%	3,127	0.3%	88%
Kualifikuar	3a	56	2%	8,277	0.7%	82%
Shkollë mesme	3c	1942	57%	12,678	15.3%	92%
Shkolla e lartë	4	12	0%	320	3.8%	92%
Universitet	5a+	426	12%	2,511	17.0%	94%

Sa u përket niveleve të ndryshme të kualifikimeve, shifrat e raportuara gjatë vitit 2014, paraqesin në mënyrë të përsëritshme rezultate të dyaneshme. Në mënyrë disproporcionale, tri grupet e kualifikimit më të lartë ende realizojnë në mënyrë propocionale përqindje shumë më lartë sesa tri grupet me kualifikim më të ulët, të cilat mbesin shumë më poshtë. Në përjashtim të grupit të pakualifikuarve të cilët përmes masave aktive kanë realizuar vlera të larta në ndërmjetësime.

Shkalla e çertifikimit në mënyrë mbi proporcionale për kategoritë me universitet (94%), pastaj shkollë e

lartë me (92%) dhe sh. mesme (92%) janë mbi vlerat mesatare të Kosovës (91%). Ndërsa kategoritë e të pakualifikuarëve (90%), gjysmë kualifikuar (88%) dhe kualifikuar (82%) janë nën vlerat e certifikimit mesatar, e cila është prej 91%.



5.2. Aftësimi sipas Moshës


Tabela 17: Aftësimi Profesional sipas Moshës

Mosha	Akumulimi për 12 Muaj	%	Papunësia	ShA 2014	ShÇ 2014
15-24	1609	47.1%	7741	20.8%	91%
25-39	1532	44.8%	41231	3.7%	91%
40-54	267	7.8%	26561	1.0%	92%
55+	11	0.3%	7790	0.1%	82%
Gjithsejte	3419	100%	83323	4.1%	91%

Qendrat e Aftësimi Profesional edhe gjate viti 2014 i kane dhënë rëndësi grup moshës se te rinjve qe ne mënyrë proporcionale grup moshë 15-24 merr pjese me 47.1%, pasuar nga grup moshë tjetër 25-39 me 44.8%. Kurse grup moshë 40-54 dhe 55+ marrin pjese me 7.8% respektivisht me 0.3%.

Shkalla e aktivizimit sipas grup moshën 15-24 arrijnë 20.8% e ndjekur nga grup moshë tjetër 25-39 me 3.7%. Ndërsa grup moshat tjera me te vjetra marrin pjesë me shifrat tejet të ulëta.

Megjithatë, shifrat aktuale konfirmojnë një prioritet të vazhdueshëm, sikurse në periudhat paraprake raportuese që i jepet nga MPMS/DPP të papunëve të rinj. Sa për të parë nga diagrami (fig.27), ngjashëm me shkallët e punësimit gjithashtu edhe shkallët e aktivizimit janë në korrelacion në mënyrë të përsëritshme me moshën.



Derisa grupi më i ri për nga moshë ka arritur një shkallë aktivizimi (ShA) prej rreth 20.8%, në veçanti pjesëmarrja në Aftësimin Profesional e të papunëve që i përkasin grupit të moshës më të vjetër (55-64), mbetet në nivel gati të parëndësishëm, vetëm prej 0.1% (shih fig 27).

Sidoqoftë, është evidente ngritja e përgjithshme e pjesëmarrjes në Aftësimin Profesional me rreth 2.1% duke iu referuar te gjitha grup moshave krahasuar me vitin paraprak.

Shkalla e Çertifikimit te kandidatëve arrijnë shifrën prej mbi 90%, ne përjashtim te grup moshës 55-64 qe është nen vlerat mesatare me vetëm 82%. Mirëpo kur kihet parasysh numri i pjesëmarrësve te kësaj moshe qe është tejet i vogël, atëherë kjo mbetet pak e rëndësishme.

5.3. Aftësimi sipas Etnitetit


Tabela 18: Aftësimi Profesional sipas Etniteteve

Aftësimi	Akumulimi për 12 muaj	%	Papunësia	ShA 2014	ShÇ 2014
Shqiptar	3126	91%	72,908	4.3%	92%
Gjithë Minoritetet	293	9%	10,415	2.8%	83%
Serb	168	5%	3,395	4.9%	87%
Tjera Minoritete	125	4%	7,020	1.8%	78%
Gjithsejte	3419	100%	83,323	4.1%	91%

Aftësimi Profesional gjatë kësaj periudhe raportuese pasqyron diferencën mjaft të theksuar të shifrave në baze të grupeve etnike. Shqiptaret përballen me tregues pozitiv të pjesëmarrjeve në Aftësimin Profesional me 3126 pjesëmarrës apo 91% e të gjitha trajnimeve, pastaj serbet me 5% ose 168 pjesëmarrës, kurse komunitetet tjera pakice marrin pjesë me 4% ose 125 pjesëmarrës.

Mirëpo shkalla e aktivizimit nxjerr në pah një ndikim shumë të vogël mbi-proportional të serbeve me 4.9% krahasuar me mesataren kosovare prej 4.1%, po ashtu edhe shqiptaret janë mbi vlerat mesatare prej 4.3%.

ndërsa minoritetet tjera marrin pjesë me 1.8%. Gjithashtu duhet theksuar edhe shkalla e çertifikimit për shqiptaret është mbi vlerën e mesatares kosovare prej 92% ndërsa serbet dhe minoritetet tjera marrin pjesë me 87% respektivisht 78%.




5.4. Aftësimi profesional sipas gjinisë

Tabela 19: Aftësimi Profesional sipas Gjinisë

Aftësimet	Akumulimi për 12 muaj	%	Papunësia	ShA 2014	ShÇ 2014
Femra	1,665	49%	36,570	4.6%	89%
Meshkuj	1,754	51%	46,753	3.8%	93%
Të gjithë	3,419	100%	83,323	4.1%	91%

Hyrjet për 12 muaj në aftësimet profesionale sipas gjinisë, tregon se përqindja e femrave në pjesëmarrje është me e mirë krahasuar me vitin paraprak sa ishte prej 45% ndërsa për këtë vit (2014) raportues është 49%. Megjithatë, ngritja e grupit të femrave me rreth 49% është trend pozitiv në raport me pjesëmarrjen e meshkujve prej rreth 51%.

Shkalla e aktivizimit për gjininë femërore është 4.6% apo me e larte sesa gjinia tjetër e cila ishte 3.8%. Realisht shkalla e aktivizimit të femrave është me e larte edhe se mesatarja kosovare e cila është 4.1%, ndërsa mashkujte janë nën proporcionin e mesatares kosovare me 3.8%. Sa i përket çertifikimit të pjesëmarrësve në Aftësimin Profesional, gjinia femërore me 89% është nën vlerat e mesatares kosovare e cila është 91%, ndërsa çertifikimi i mashkujve prej 93% është mbi vlerat proporcionale të mesatares kosovare dhe është dukshëm me mirë se gjinia femërore.




5.5. Aftësimi sipas Rajoneve

Tabela 20: Aftësimet Profesionale sipas Rajoneve

Aftësimet	Akumulimi për 12 muaj	%	Papunësia	ShA 2014	ShÇ 2014
Ferizaj	397	12%	11,339	3.5%	92%
Gjakovë	462	14%	7,621	6.1%	94%
Gjilan	474	14%	11,357	4.2%	92%
Mitrovicë	423	12%	12,800	3.3%	91%
Pejë	583	17%	7,212	8.1%	88%
Prishtinë	387	11%	17,990	2.2%	92%
Prizren	693	20%	15,004	4.6%	92%
Gjithsejta	3,419	100%	83,323	4.1%	91%

Zhvillimi i kapaciteteve të aftësimeve profesionale (AP) sipas rajoneve, pasqyron rezultate të ndryshme, rajoni i Prizrenit në mënyrë proporcionale dominon me 20% ose 693 pjesëmarrës kundrejt rajoneve tjera. Pas këtij rajoni renditet Rajoni i Pejës me 17% ose 583 pjesëmarrës në trajnime. Rajoni me aktivizimin më të ulte është Prishtina me 11% ose 387 pjesëmarrës, pasojnë rajoni i Ferizajit (397) dhe Mitrovicës (423) me 12%.

Duke iu referuar kapaciteteve të realizuara të Aftësimin Profesional në shifra absolute me mesataren e mbledhur të të regjistruarve si të papunë në rajonet e ndryshme, shkalla



më e lartë e aktivizimit (ShA) në vitin 2014 ishte arritur në rajonin e Pejës me 8.1%, pasuar nga rajoni i Gjakovës me 6.1%. Ndërsa shkalla aktivizimit më e ulte pasqyron rajonin e Prishtinës me 2.2%.

Zhvillimi i Shkallës së Aktivizimit vë në dukje një rritje të vazhdueshme të kontrasteve sa i përket pjesëmarrjes në Aftësimin Profesional, përkatësisht kapaciteteve.

Aneks A: Projektet e realizuara gjatë vitit 2014

Gjatë vitit 2014 Departamenti i Punës dhe Punësimit ka vazhduar me hartimin dhe realizimin e dokumenteve nga fusha e punës dhe punësimi si dhe aftësimeve profesionale.

Ka monitoruar, vlerësuar, mbikëqyr dhe realizuar politikat e punësimi dhe aftësimeve profesionale përmes dy divizioneve të punësimi dhe aftësimeve profesionale. Ka vazhduar të siguroj dhe ofroj ndihma dhe këshilla profesionale, teknike dhe ka bërë monitorimin e aktiviteteve të divizioneve në nivel qendrorë dhe të shërbimeve të punësimi e të trajnimeve në nivel horizontal lidhur me implementimin e politikave të punësimi projekteve dhe të aftësimeve në nivel të Kosovës.

Ka nxitë bashkëpunimin brenda dhe jashtë Kosovës në zhvillimin e politikave të punësimi dhe aftësimeve profesionale. Ka ofruar mbështetje në realizimin e planeve dhe programeve vjetore, mujore dhe javore në nivelin të punësimeve dhe aftësimeve profesionale. Është angazhuar për mbështetje dhe bashkëpunim të plotë dhe efektiv ndërmjet të gjithë faktorëve që kanë të bëjnë me sferën e punës dhe punësimi.

Ka nxitë dhe zhvilluar bashkëpunim me ndërmarrjet që kanë ndikim në zhvillimin e tregut të punës në nivel të Kosovës dhe jashtë sajë, të hartoj buxhetin në nivel të Departamentit të Punës dhe Punësimi. Ka bërë planifikimin e nevojave për burime njerëzore dhe ka bërë rekrutimin e personelit në nivel të Departamentit të Punës dhe Punësimi.

Departamenti i Punës dhe Punësimi përmes Divizionit të Punës dhe Punësimi ka vazhduar të bëjë realizimin e politikave dhe masat aktive të punësimi përmes shtatë (7) Qendrave Regjionale për Punësim me njëzet e tri (23) Zyra Komonale për Punësim dhe 6 Nën zyra Komonale për Punësim, 8 Qendrave për Aftësime Profesionale.

Për realizimin e politikave aktive të punësimi dhe ngritjen e punësueshmërisë, Divizioni i Punës dhe Punësimi ka bashkëpunuar ngushtë në realizimin e një numri të caktuar të projekteve me MBPZhR, APK, MTPT, UNDP- në, Kosvet VI, BB, Komunat, AKB dhe me institucionet tjera vendore dhe të jashtme si:

Programet dhe projektet aktive në tregun e punës:

1. Projekti, Kosvet VI, komponenta e trajnimit në punë. Ky projekt është mbështetur financiarisht nga Komisioni Evropian, është realizuar në partneritet me MPMS, përkatësisht DPP-në, konkretisht Zyrat e Punësimi. Projekti ka përfunduar në shtator. Nga ky projekt kanë përfituar gjithsej 1800 punëkërkues.
2. Projekti, Rritja e Punësimi për Grupet e Cenueshme në Tregun e Punës. Ky projekt është duke u financuar nga Komisioni Evropian. Realizohet në partneritet me MPMS-në. Projekti do të vazhdoj edhe vitin e ardhshëm.
3. Projekti, Tregu Aktiv i Punës për Gjenerim të Punësimi (ose i njohur ndryshe si ALMP 2). Projekti realizohet nga UNDP (financohet nga Qeveria e Punëve të Jashtme e

Finlandës dhe MPMS). Realizohet në partneritet me MPMS-në. Në skemën trajnim në punë nga ky projekt kanë përfituar 210 kandidatë.

4. Projekti, Rritja e Mundësive për Punësimin e të Rinjve (EYE). Projekti financohet nga Qeveria e Zvicrës. Një komponentë e projektit realizohet në bashkëpunim me MPMS-në, përkatësisht Departamentit të Punës dhe Punësimit (Shërbimet Publike të Punësimit).
5. Projekti, Kosova e Bukur II. Projekti financohet nga Komisioni Evropian. Implementohet nga IOM-i në partneritet me MPMS-në (Zyrat e Punësimit). Nga ky projekt janë financuar 26 projekte të punëve publike në komuna. Do të angazhohen gjithsej 1288 punëkërkuar, prej tyre 803 do të jenë nga Zyrat e Punësimit. Gjatë këtij viti janë realizuar 7 projekte, do të vazhdohet me projektet tjera vitin e ardhshëm.
6. Projekti i UNDP për të ri-atëdhësuarit në bashkëpunim me MPMS. Në këtë projekt, përmes Zyrave të Punësimit kanë përfituar 129 përfitues, në skemat e trajnimit në punë dhe subvencionim në pagë, për periudhën 6 muaj deri në 1 vit.
7. Projekti, sanimi i gjendjes në pyje nga zjarret, aktivitetet silvikulturore (rrallime, çlirime, pastrime dhe krasitje) hapje korridoresh dhe damkimin e masës drurore nga MPMS në bashkëpunim me Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nga zyrat e punësimit janë ndërmjetësuar 650 punëkërkuar. Kohëzgjatja e projektit ishte dy muaj. Është viti i peste që zhvillohet.
8. Projekti, mbrojtja e pyjeve nga zjarret, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Kanë përfituar 120 punëkërkuar. Kohëzgjatja e projektit 4 muaj.
9. Projekti, ndërtimi i pusetave dhe montimi i ujëmatësve, në komunën e Malishevës, kanë përfituar 50 punëkërkuar. Kohëzgjatja e projektit 3 muaj.
10. Projekti, praktikantë – operatorë për futjen e te dhënave SNS në Qendrat për Asistencë Sociale dhe Zyrat e Punësimit. Në këtë projekt kanë përfituar 57 punëkërkuar me shkollim te nivelit superior. Kohëzgjatja e projektit 3 muaj.
11. Projekti, promovimi i punësimit dhe rritjes së mundësive për të rinjtë, është realizuar nga MPMS-IZHI (Instituti për Zhvillim dhe Integrim) dhe Ambasada Norvegjeze. Projekti trajnoi dhe çertifikoi 300 pjesëmarrës.
12. Projekti, vjelja e rrushit në Stone Castle. Në plantacionet Stone Castle me ndërmjetësim nga Zyra e Punësimit Gjakovë janë angazhuar 205 punëkërkuar për periudhën 2-3 muaj.
13. Shënimi i masës drurore në Duboqak. Në këtë projekt përmes Zyrës së Punësimit Skenderaj janë angazhuar 7 punëkërkuar, në aktivitetin shënimi i masës drurore, për periudhën 4 muaj. Projekti është realizuar nga MPMS në bashkëpunim me MBPZHR.

Pasqyra e realizimit te projekteve per ndërmjetësim ne punësim ne boten e jashtme							
Titulli i Projekteve	Instituc. Përgjegjëse për Realizimin e Projektit	Memorandumet e Bashkëpunimit	Nr. i Kandidatëve të cilët kanë aplikuar	Nr. i Kandidatëve të cilët kanë marr pjesë në Intervista	Nr i Kandidateve të Përzgjedhur për tu Ndërmjetësuar	Kandidatet e ndërmjetësuar gjerë me tani	Kohëzgjatja e Punësimit ose Praktikës .
Projekti “Punë(P praktik) Sezonal e e Studentëve në Zvicër”	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ne Bashkëpunim me Organizatën Agroimpuls ne Zvicër	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit ne Organizatën Agroimpuls me datën 04.04.2013	11	11	2	2	4 Muaj
Punë Praktik e në Infermeri në Cyrih-Zvicër	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ne Bashkëpunim me Ministrin e Punëve të Jashtme	MPMS ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me MPJ Ndërsa MPJ ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Qendrën për perkujdesje të personave të moshuar	81	22	10	Pritet që të shkojnë me 01.02.2015	1 Vit
Totali			92	33	22	2	

Vërtetimet për lajmërimin e punës për shtetas te huaj “30, 60 dhe 90 dite”

Qe nga Shtatori i vitit 2013 është ne fuqi Ligjin nr. 04/L-219 për të Huajt i cili rregullon hyrjen, qëndrimin si dhe punësimin e te huajve.

Vërtetimi për lajmërimin e punës për te huaj rregullon angazhimin e te huajve në shërbimet në kohëzgjatje deri më 90 ditë brenda vitit kalendarik, kjo është rregulluar në baze te Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huajt si dhe te Udhëzimit Administrative 01/2014 i cili rregullon Procedurën e lëshimit të Lejës së Qëndrimit për te Huajt dhe Vërtetimit për Lajmërimin e Punës.

Vërtetim për Lajmërimin e Punës për Shtetas te Huaj				
Shtetësia	2014			
	90 Dite	60 Dite	30 Dite	Gjithsejte
Shqiptar	1	0	0	1
Francez	1	0	0	1
Boshnjak	9	0	0	9
Gjerman	13	0	0	13
Maqedon	33	0	0	33
Polak	14	0	0	14
Portugez	02	0	0	02
Romun	30	0	0	30
Turq	8	0	0	8
Serb	5	0	0	5
Totali	116	0	0	116

Aneks B: Treguesit e Tregut të Punës³

TABELA 6.1: Përmbledhja e tregut të punës 2012 & 2013

	Kosovë 2012	Kosovë 2013
Shkalla e jo-aktivitetit (%)	63.1	59.5
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (%)	36.9	40.51
Meshkuj	55.4	60.2
Femra	17.8	21.1
Shkalla e punësimit	25.6	28.4
Meshkuj	39.9	44.0
Femra	10.7	12.9
Me orar të pjesshëm (si % e të punësuarve)	11.1	11.9
Meshkuj	11.3	11.1
Femra	10.3	14.3
Të punësuar të përkohshëm (si % e të punësuarve)	73.0	68.8
Meshkuj	73.2	68.9
Femra	72.5	68.7
Të vetë-punësuar (si % e të punësuarve)	19.8	22.9
Meshkuj	22.7	26.0
Femra	8.3	12.8
Shkalla e papunësisë (%)	30.9	30.0
Meshkuj	28.1	26.9
Femra	40.0	38.8
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (% e grupmoshës 15-24)	55.3	55.9
Meshkuj	52.0	50.4
Femra	63.8	68.4
Papunësia afatgjate (12+ muaj të të pa punëve)	59.8	68.9
Meshkuj	59.1	71.08
Femra	61.3	68.98

Tabela 6.1 tregon që shumica e indikatorëve të tregut të punës kanë mbetur të ngjashëm me ata të dy viteve të shkuara. Kjo nuk është e befasishme duke pasur parasysh mungesën e ndryshimeve të mëdha në ekonominë e Kosovës nga viti 2012 në vitin 2013 dhe shkallën modeste të rritjes ekonomike gjatë kësaj periudhe. Shkalla e papunësisë ka rënë vetëm pak, nga 30.9% në 30.0%. Ndryshimi më sinjifikant ka ndodhur në shkallën e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, e cila është rritur nga 36.9% në 40.5%. Nga viti 2012 në 2013, popullsia në moshë pune është rritur për vetëm 2,611 persona, por numri i shënuar si ekonomikisht aktivë është rritur për rreth 45,000. Numri i personave të shënuar si të punësuar është rritur për rreth 35,000, duke rritur shkallën e punësimit (ose raportin punësim ndaj popullsisë) për rreth tri pikë përqindjeje, nga 25.6% në 28.4%.

Është e mundur që rritjet në pjesëmarrjen në fuqinë punëtore dhe punësimi në vitin 2013 janë të mbivlerësuara. Këta indikatorë duket të mos jenë raportuar plotësisht në AFP-në e vitit 2012, ndërkohë që AFP-ja e vitit 2013 ka qenë më përfshirëse në kuptimin e regjistrimit të punëve të vogla, përfshirë punën familjare të papaguar. Prandaj, disa nga rritjet e dukshme në vitin 2013 me gjasë mund t'i atribuohen përmirësimit të metodologjisë së anketës. Megjithatë, ka gjithashtu mundësi që një pjesë e rritjes, si punësimi, ka ndodhur për shkak të rritjes së vërtetë të vendeve të punës, mbështetur nga rritja e regjistrimeve për bizneset e reja në vitin 2013.

³ Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë 2014, ASK.

Aneks C: Të dhëna dhe diagrame për punësimin

Tab. 26: Shkalla e ndërmjetësimeve ne punësim sipas Komunave 2014

Rajoni	Komuna	Papunësia	Punësimi	Shkalla e Punësimit
Prishtinë		17990	896	5.0%
	Prishtinë	6955	182	2.6%
	Fushë-Kosovë	1129	178	15.8%
	Glllogoc	2348	29	1.2%
	Lipjan	2385	118	4.9%
	Novobërdë	778	106	13.6%
	Obiliq	1089	130	11.9%
	Podujevë	2867	116	4.0%
	Graçanicë	439	37	8.4%
Prizren		15004	834	5.6%
	Prizren	6432	350	5.4%
	Rahovec	3080	91	3.0%
	Suharekë	2671	274	10.3%
	Dragash	2821	119	4.2%
Ferizaj		11339	331	2.9%
	Ferizaj	8201	159	1.9%
	Kaçanik	1414	67	4.7%
	Shtime	870	55	6.3%
	Shtërpcë	854	50	5.9%
Gjilan		11357	815	7.2%
	Gjilan	4592	385	8.4%
	Viti	3193	226	7.1%
	Kamenicë	3572	204	5.7%
Gjakovë		7621	664	8.7%
	Gjakovë	3534	373	10.6%
	Deçan	2178	161	7.4%
	Malishevë	1909	130	6.8%
Pejë		7212	706	9.8%
	Pejë	4515	383	8.5%
	Istog	1076	192	17.8%
	Klinë	1621	131	8.1%
Mitrovicë		12800	421	3.3%
	Mitrovicë	4973	159	3.2%
	Skenderaj	5034	102	2.0%
	Vushtrri	2617	160	6.1%
	Zvečan	37	-	-
	Zubin Potok	61	-	-
	Leposaviq	78	-	-
Gjithsejte		83,323	4,667	5.6%

C.2. Kërkesa për fuqi punëtore: Vendet e lira dhe punësimet

Tabela 27: Punësimet sipas sektorit / NACE					
		2012	2013	2014	Rritje
A	Bujqësi/ Pylltari	1190	660	1075	-44.5%
B	Peshkatari	-	-	-	-
C	Xehetari	3	5	0	66.7%
D	Prodhim	768	579	392	-24.6%
E	Elektrikë / gaz / ujë	26	83	15	219.2%
F	Ndërtim Civil	1326	408	534	-69.2%
G	Tregti	1144	815	728	-28.8%
H	Hotelier / Gastronomi	307	240	282	-21.8%
I	Transport / Komunikacion	75	41	42	-45.3%
J/K	Financa / Sigurime / etj.	35	25	25	-28.6%
M	Arsim	154	171	98	11.0%
N	Shëndetësi / Mbrojtje Sociale	219	130	88	-40.6%
O	Shërbime	2388	1530	1361	-35.9%
Q	OJQ / Org. Ndërkombëtare	57	42	27	-26.3%
	Sektori Primar	1190	660	1075	-44.5%
	Sektori Sekondar	2123	1075	941	-49.4%
	Sektori Terciar	4379	2994	2651	-31.6%
	Të gjithë	7692	4729	4667	-38.5%




(Këto tabela paraqesin saktësisht punësimet e realizuara. Megjithatë një krahasim i të dy tabelave duhet të nxjerri ende potenciale ekzistuese në fushën e procedimit të të dhënave dhe kuptimit të rrjedhës së punës.)




Tabela 28: Vendet e Lira sipas sektorit / NACE					
		2012	2013	2014	Rritje
A	Bujqësi/ Pylltari	1149	605	996	-47.3%
B	Peshkatari	-	-	-	-
C	Xehetari	0	8	0	-
D	Prodhim	1030	712	764	-30.9%
E	Elektrikë / gaz / ujë	23	94	52	308.7%
F	Ndërtim Civil	1929	651	598	-66.3%
G	Tregti	1536	1063	971	-30.8%
H	Hotelier / Gastronomi	494	460	520	-6.9%
I	Transport / Komunikacion	77	54	52	-29.9%
J/K	Financa / Sigurime / etj.	25	27	37	8.0%
M	Arsim	207	341	242	64.7%
N	Shëndetësi / Mbrojtje Sociale	136	1190	94	775.0%
O	Shërbime	2664	1734	2126	-34.9%
Q	OJQ / Orga. Ndërkombëtare	164	41	114	-75.0%
	Sektori Primar	1149	605	996	-47.3%
	Sektori Sekondar	2982	1465	1414	-50.9%
	Sektori Terciar	5303	4910	4156	-7.4%
	Të gjithë	9434	6980	6566	-26.0%

C3. Regjistrimi i personave me aftësi të kufizuara

Tab. 29: Të regjistruarit me aftësi të kufizuara					
	Papunësia	Punësimi	Shkalla Punësimit	Trajnime	Shkalla e Trajnimit
Të gjithë	322	6	1.9%	51	15.8%
Meshkuj	96	6	6.3%	23	24.0%
Femra	226	0	0.0%	28	12.4%

Aneks D: Kërkesat gjatë vitit 2014





Definicionet dhe Terminologjia

Të gjithë Kapitujt:

Me qëllim të identifikimit të një dallimi dhe interpretimi që del nga ky raport, definicionet dhe terminologjia që përdoren janë të shpjguara në vijim:

- **Popullata** është popullatë që banon brenda territorit të Kosovës.
- **Popullata e moshës punuese** përmban një pjesë të popullatës banuese brenda moshës 15-64, e orientuar në ligjin ekzistues të punës.
- **Punëkërkuesit** - janë të gjithë personat që kërkojnë punë duke përfshirë edhe personat që punojnë me orar të plotë apo gjysmë orari dhe personat që janë suspenduar përkohësisht nga puna;
- **Të papunët** i referohen – sipas definicioneve të ILO-s – personave që kanë moshë pune, të cilët janë:
 - a) Te pa punë,
 - b) duke kërkuar punë dhe
 - c) janë në dispozicion për punë.
- **Të Papunësuarit (e regjistruar)** – u referohen personave të cilët janë të *regjistruar si të papunësuar* (Këta duhet të jenë persona të cilët janë pa punë, mirëpo janë në kërkim të punës, sidoqoftë, kjo kërkesë implementohet vetëm pjesërisht në Kosovë dhe në shumicën e vendeve tjera).
- **Të Papunët afatgjatë** janë personat, të cilët janë të regjistruar si të papunësuar për më shumë se 12 muaj: ky raport i referohet proporcionit të llogaritur të papunësisë afatgjate, e cila është nën kushtin [dalje<regjistrime] dhe [hyrje-regjistrime] në:

$$\text{- rastin më të keq} = \frac{[\text{papunësuar} - (\text{dalje} - \text{hyrje})]}{\text{papunësuar}} * 100 \quad | \text{ nën kushtin e zbritjes së regjistrimeve.}$$

$$\text{- rastin më të mirë} = \frac{[\text{papunësuar} - (\text{hyrje} + \text{dalje})]}{\text{Papunësuar}} * 100$$

$$\text{- rastin më të keq} = \frac{[\text{papunësuar} - (\text{hyrje} - \text{dalje})]}{\text{Papunësuar}} * 100 \quad | \text{ nën kushtin e rritjes së regjistrimeve.}$$

- **Te Punësuarit** janë të identifikuar prej definicionit në vijim të ILO/EUROSTAT-it si:

“Një person është i konsideruar si i punësuar nëse ai apo ajo ka bërë ndonjë punë për pagë apo profit. ...Vetë të punësuarit janë po ashtu të konsideruar që janë duke punuar,

nëse (personi) ,, punon në afarizmin e tij, praktikë profesionale apo fermë për qëllime të përfitimit të profitit,, shpenzon kohë në operimin e afarizmit ,, është nën proces të themelimit të një afarizmi, ... Një punëtor i papaguar është thënë të jetë duke punuar nëse puna kontribuon direkt tek një afarizëm, fermë apo praktikë profesionale e pronësuar apo e drejtuar prej një anëtarë në lidhje me të njëjtit shtëpimbajtës”.

Termi “i punësuar” nënkupton personat me punësim të rregullt, të vetëpunësuarit (duke përfshirë bizneset e vogla – dhe pronarët e fermës), punëtorët e fermës, anëtarët e familjes që kontribuojnë (p.sh. në shitore dhe ferma) dhe – brenda gjithë asaj – nën – persona të punësuar: ndokush, që është më i vjetër se 15 vjet dhe – që punon për qëllim fitimi profit apo të ardhura (duke përfshirë edhe ata që nuk janë të suksesshëm të arrijnë një gjë të tillë).

- ➔ **Popullata Aktive** përbëhet prej: të regjistruarve si të papunë plus të punësuarve.
- ➔ **Shkalla e Papunësisë** përkatësisht shkalla e regjistrimit të papunësisë është proporcioni i të regjistruarve si të papunë prej popullatës ekonomisht aktive.
- ➔ **Përpjesëtimi i Papunësisë** i referohet regjistrimit të papunësisë tek popullata me moshë të punës, përpjesëtimi i papunësisë këtu është i barabartë tek *përpjesëtimi i regjistruar i papunësisë* respektivisht tek *shkalla e regjistrimit*.

➔ **Grup moshat:**

➔ 15-24, 25-39, 40-54, 55-64

➔ **Grupet Etnike:**

➔ Shqiptarë, Serbë, Malazez, Ashkalinj, Romë, Turq, Boshnjakë, të tjerë.

Për qëllime të analizave një klasifikim i shkurtër do të përdoret gjithashtu: shqiptar, “gjithë minoritarët”, serbë dhe “minoritete tjera” (pa serbë).

- ❖ **Përpjesëtimi i Papunësisë në Raport me Stafin** i referohet numrit të papunësuarve të nëpunësve të punësimit (pa pastrues dhe sigurim – por përfshirë stafin administrativ).
- ❖ **Shkalla e Hyrjes** është pjesa e numrit mesatar mujor të të papunësuarve të fundit të regjistruar nga numri mesatar i regjistrimit të papunësisë gjatë vitit. Me qëllim të një krahasimi më të mirë, ky raport pjesërisht i referohet shkallës së akumuluar për 12 muaj.
- ❖ **Shkalla e Daljes** është pjesa e numrit mesatar të shumës mujore të punësimeve dhe regjistrimit të fshirë të papunësisë nga numri mesatar i regjistrimit të papunësisë gjatë vitit. Me qëllim të një krahasimi më të mirë, ky raport pjesërisht i referohet shkallës së akumuluar për 12 muaj.
- ❖ **Daljet sipas Stafit** (daljet e llogaritura sipas stafit për total 12 muaj)
- ❖ **Hyrjet sipas Stafit** (hyrjet e llogaritura sipas stafit për total 12 muaj).

- ❖ **Të ç'regjistruar** përfaqëson ata persona si pjesë e daljes, të cilët janë të larguar prej klasifikimit "të regjistruar si të papunë" e ndarë prej arsyes "punësim" – nëse:
 - puna është gjetur me përpjekjet e veta,
 - pa interes të mëtejshëm në shërbimet e zyrave të punësimi,
 - asnjë kontakt me zyrat e punësimi brenda një periudhe të pajtuar,
 - mosha punuese ka kaluar.

(Ndërmjetësimi i Punësimi):

- **Shkalla e Regjistrimi të Vendeve të Lira të Punës** - është një numër i vendeve të lira të krijuara nëpërmjet shërbimeve të punësimi gjatë vitit. Në lidhje me numrin e regjistruar të të papunësuarve në fund të vitit (është një prejardhje e përpjesëtimeve të vendeve të lira/papunësi si një numër i vendeve të lira për regjistër të personave të papunësuar).
- **Shkalla e krijimit të vendeve të lira sipas stafit** i referohet numrit të vendeve të lira të krijuara në raport me numrin e zyrtarëve të punësimi (pa pastrues dhe sigurim, por përfshirë stafin administrativ).
- **Shkalla e Punësimi** përbën numrin e ish të papunësuarve që kanë themeluar marrëdhënie të punës nëpërmjet shërbimeve të punësimi gjatë vitit, në lidhje me numrin e regjistrimit të papunësisë në fund të vitit (është një prejardhje e përpjesëtimeve si një numër i punësimeve për personat në regjistrin e personave të papunë).
- **Punësimet në raport me stafin** u referohet punësimeve në raport me numrin e zyrtarëve të punësimi (pa pastrues dhe sigurim, por përfshirë stafin administrativ).
- **Shkalla e Punësimi – Vendeve të Lira** është numri i punësimeve të realizuara në raport me numrin e vendeve të lira të krijuara prej shërbimeve të punësimi gjatë vitit.
- **Sektorët sipas Aktiviteteve** janë të orientuar në klasifikimin standard ndërkombëtar të aktiviteteve ekonomike, NACE (Rev. I), por ende jo plotësisht i përshtatshëm:
 - (A) bujqësi / pylltari
 - (B) peshkim
 - (C) minierë
 - (D) prodhimtari
 - (E) rrymë / Gaz / ujë
 - (F) ndërtim
 - (G) tregti
 - (H) hotelieri / gastronomi

- ⇒ (I) transport / komunikim
- ⇒ (J / K) financa / patundshmëri etj.
- ⇒ (M) arsimim
- ⇒ (N) / mbrojtje sociale
- ⇒ (O) shërbimet (OJQ)-të / organizatat

➤ **Sektorët Ekonomik:**

- ⇒ Sektori primar (A-B)
- ⇒ sektori sekondar (C-F),
- ⇒ sektori terciar(G-O,Q).

➤ **Sektorët sipas Pronarit:**

- ⇒ Sektori publik: qeveritar dhe institucionet e kontrolluara nga qeveria dhe ndërmarrjet.
- ⇒ Sektori privat: individët privatë, fermat, bizneset dhe kompanitë.

(Trajnimi Profesional):

- **Shkalla e aktivizimit** paraqet pjesën e personave që fillojnë trajnimin (Aktivizimi) brenda 12 muajve nga numri mesatar i të regjistruarve si të papunë gjatë kësaj kohe.
- **Shkalla e Certifikimit** paraqet pjesën e personave të certifikuar në një trajnim gjatë vitit nga numri i pjesëmarrësve gjatë vitit.

KSNA/ISCED: Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimimit

- **SNKAE 0: Arsimimi parafillor:** Faza fillestare e instruksioneve të organizuara, së pari të njoftuar si fëmijë shumë të vegjël për një ambient shkollor. Programe të tilla janë në shkolla apo të organizuara nëpër qendra, për fëmijët e moshës së paku 3-vjeçare.
- **SNKAE 1: Arsimimi fillor:** Fillimi i studimeve sistematike me të lexuar, shkrimi dhe matematika. Programet janë disenjuar në bazë njësie për projekt (shpesh me një mësues për shumicën e kohës) më shumë sesa në bazë të lëndës (me mësues të ndryshëm për lëndë të ndryshme). Moshë e hyrjes është prej 5 deri 7 vjeç.
- **SNKAE 2: Arsimimi i ulët sekondar:** Fillimi i të mësuarit bazuar në lëndë – për të kompletuar provizionin e arsimimit elementar që ka filluar në SNKAE 1 dhe për ta shtrirë

themelin për një mësim afatgjatë. Implementimi i plotë i aftësive elementare ngjan në këtë nivel. Kjo fazë është me nënndarje:

- SNKAE 2A programet janë disenjuar për qasje direkte në SNKAE 3 sipas radhës, e cila do të shpinte tek arsimimi terciar.
- SNKAE 2B programet janë të disenjuara për qasje direkte në SNKAE 3C.
- SNKAE 2C programet janë të disenjuara së pari për qasje direkte në tregun e punës. Për të përparuar tek SNKAE 3 kërkohet gjithashtu kompletim i SNKAE 2A apo 2B.

➔ **SNKAE 3: Arsimiti sekondar (më i lartë):** Specializime të mëtutjeshme krahasuar më SNKAE 2. Kjo fazë fillon në fund të shkollimit të detyruar 15 apo 16. përfundimi i suksesshëm i SNKAE 2 është i kërkuar. Kjo fazë vazhdon edhe me nënndarje:

- SNKAE 3A programet janë disenjuar për qasje direkte tek SNKAE 5A.
- SNKAE 3B programet janë disenjuar për qasje direkte tek SNKAE 5B.
- SNKAE 3C programet nuk shpiejnë direkt tek arsimimi terciar. Për të përparuar tek SNKAE 5A apo 5B kërkohet gjithashtu përfundimi SNKAE 3A, 3B apo 4A.

➔ **SNKAE 4: Arsimiti pas shkollës së mesme joterciar:** Programe, të cilat kanë larguar kufijtë ndërmjet shkollimit të mesëm të lartë dhe shkollimit pas shkollës së mesme. Përmbajtja nuk është e mjaftueshme që të quhen programe terciare. Të shumtën e herëve jo më të përparuara se SNKAE 3 – që të zgjerojë njohuritë e studentëve të cilët e kanë kryer SNKAE 3. Programe për përgatitje për hyrje në arsimimin terciar.

Kjo fazë është ende me nënndarje:

- SNKAE 4A programet janë të disenjuara për qasje direkte tek SNKAE 5.
- SNKAE 4B programet janë të disenjuara së pari për qasje direkte tek tregu i punës dhe nuk i japin qasje SNKAE 5.

➔ **SNKAE 5: Faza e parë e arsimimit terciar:** Programet përmbajtja e të cilave është më e avancuar sesa SNKAE 3. Hyrja në këto programe kërkon përfundimin e suksesshëm të programit në SNKAE 3A, 3B apo 4A. Kjo fazë ka edhe nënndarjet:

- SNKAE 5A kryesisht bazohet në teori, duke tentuar të japë qasje ose tek hulumtimet e programeve të avancuara të SNKAE 6 apo tek profesionet me kërkesa për kualifikim më të lartë (p.sh. mjekët). Mund të jetë e domosdoshme që të kenë më shumë se sa një kualifikim në SNKAE 5A (p.sh. një diplomë fakulteti dhe më vonë magjistrature) para hyrjes në SNKAE 6.

- ⇒ SNKAE 5B programet fokusohen në kualifikime specifike profesionale me qasje direkt në tregun e punës. Ato shpesh janë më të shkurtra se programet në SNKAE 5A. Përmbajtja e tyre teorike është zakonisht e pamjaftueshme që të ofrohet qasje e avancuar në programet hulumtuese (para se të kompletohet programi në SNKAE 5A).

- ➡ **SNKAE 6: Faza e dytë e arsimimit terciar:** Programet, të cilat shpëjnë në shpërblimin e një kualifikimi të avancuar (zakonisht nivel doktorate apo më tutje). Programet u janë kushtuar studimeve të avancuara dhe hulumtimeve origjinale dhe nuk janë bazuar vetëm në kurse.

Referencat

Euro Stat (2003):	Hulumtimi i fuqisë punëtore e Unionit Evropian, metodat dhe definicionet 2001, Luksemburg
ETF / Pirher, Sonja (2003):	Zhvillimi dhe Ndërtimi i Kapaciteteve në fushën e Edukimit dhe Statistikave mbi Tregun e Punës, Torino
ILO (1982):	Rezoluta për statistikën e popullatës ekonomikisht aktive, punësimi, papunësia dhe niveli i ulët i punësimit, Gjenevë
ILO (1998):	Rezoluta për matjen e punësimit dhe situatave joadekuata të punësimit
ILO / MPMS-DPP (2006):	Plani i Veprimit për Punësimin e Rinisë Kosovare
MPMS-DPP (2014c):	Informatat mbi Tregun e Punës në Kosovë (mujor), Prishtinë
MPMS-DMS / ESK (2007):	Statistikat e Mirëqenies Sociale
ESK (2014):	Analizë e Fuqisë Punëtore (AFP) 2013, Prishtinë
UNDP (2004):	Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2004, Prishtinë

Shumë burime tjera mund të gjinden edhe në:

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Kosovë www.mpms-ks.org

Qeveria e Kosovës www.rks-gov.net

Statistikave të Kosovës <http://esk.rks-gov.net/>

Zyra Ndërkombëtare e Punës www.ilo.org

UNDP në Kosovë www.kosovo.undp.org

Botërore në Kosovë www.worldbank.org/kosovo

BE në Kosovë www.euinkosovo.org

OSBE në Kosovë: www.osce.org/kosovo

Ueb faqja për burime të punës: www.lmps.gofor.de



Raporti Vjetor 2014

Puna dhe Punësimi në Kosovë

www.mpms.rks-gov.net